



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM Nr.50

Dt. 30.10.2024

‘PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL 2024-2027 PËR BASHKINË VORË ’

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 ‘Për vetëqeverisjen Vendore’, ligjit nr.121/2016 ‘Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë’ neni 36 pika ‘c’, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.111 datë 23.02.2018 për krijimin dhe funksionimin e fondit social, Këshilli i Bashkisë Vorë pasi shqyrtoi draft planin e përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social.

VENDOSI

1. Miratimin e Planit Social në Bashkinë Vorë
2. Për Zbatimin e këtij plani ngarkohen Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas Konfirmimit Ligjor nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë.

KRYETARE KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





BASHKIA VORË

Nr. 3001 / Prot.

Vorë, më 30.10.2024

Plani Social Vendor

2024-2027

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE.....	4
1. Vizioni.....	4
2. Misioni.....	Error! Bookmark not defined.
3. Parimet e Planit Social Vendor	4
II. ANALIZA E SITUATËS	5
1. Kuadri strategjik.....	5
2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet	6
Vlerësimi i nevojave	6
Të dhënat demografike	6
Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale	7
Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme	7
Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë	7
Punëkërkuarit e papunë	9
Individë me aftësi të kufizuar	11
Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje	11
Viktima të dhunës në familje.....	12
Individë/familje në nevojë për strehim social.....	16
Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi	16
Individë që kanë varësi nga alkooli	17
Individë që kanë varësi nga droga	18
Persona LGBTIQ+.....	18
Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	Error! Bookmark not defined.
Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta brenda organizatës	19
Analiza e burimeve njerëzore.....	19
Analiza PESTLE	21
Analiza SËOT	22
III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	23
IV. PLANI I VEPRIMIT.....	23
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	39
VI. ANEKSI 1 - TABELAT	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike "Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri" (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Hasit zbatuar nga GOPA Eorldeide Consultants.

HYRJE

Bashkia Vorë kufizohet në veri me bashkinë Krujë, në lindje me bashkinë Kamëz, në jug me bashkinë Tiranë, në jug-perëndim me bashkinë Shijak dhe në lindje me bashkinë Durrës. Bashkia ka një pozicion gjeografik tejet të favorshëm, pasi lidh Tiranën me Durrësin, si dhe veriun me jugun e vendit. Në bashkinë Vorë janë të regjistruara 800 biznese të mëdha, kryesisht industri e lehtë dhe ndërtim. Këtë potencial ekonomik e tregon edhe rritja e grupmoshës aktive për punë (19-59 vjeç) me 367 banorë në Bashkinë Vorë për periudhën 2021-2023 e lidhur me përmirësimin e kushteve të jetesës dhe një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në zonë.

Sipas të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në prill 2023 në këtë Bashki rezultojnë të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile 40,787 banorë. Duket se popullsia në këtë Bashki ka ardhur duke u rritur ndër vite. Në 2015 në këtë Bashki ishin të regjistruar 36,230 banorë. Megjithatë numri i banorëve që jetojnë fizikisht në këtë Bashki është më i vogël se sa tregojnë të dhënat e gjendjes civile. Të dhënat e Censurit të vitit 2011 japin një popullsi prej 25,511 banorësh. 64% e popullsisë së regjistruar në gjendjen civile jetojnë fizikisht në këtë territor.

Bashkia është e organizuar në tre njësi administrative: Vorë, Bërxull dhe Prezë. Në Vorë gjejmë 53% të popullsisë, në Bërxullë 29% të saj dhe në Prezë 18% të popullsisë.

Janë 12,074 familje në këtë Bashki (sipas gjendjes civile në nëntor 2023). Numri mesatar i pjesëtarëve në familje në Bashkinë Vorë është 3,3. Duke analizuar grupmoshat, në vitin 2023 shihet një tendencë në ulje të grupmoshës 0-19 vjeç me 96 fëmijë. Vetëm grupmosha 0-4 vjeç ka shënuar një ulje prej 58 fëmijësh, duke treguar uljen e numrit të lindjeve në këtë njësi. Nga ana tjetër numri i popullsisë mbi 60 vjeç është rritur me 917 banorë, duke reflektuar një tendencë të rritjes së jetëgjatësisë në Bashkinë Vorë.

Pjesë e kësaj popullsie janë edhe individë që përveçse shërbimeve të Bashkisë që targetojnë nevojat e të gjithë popullsisë kanë të nevojshme të tjera shërbime specifike të cilat në thelb duhet të mundësojnë mirëqenien, pavarësinë dhe përfshirjen shoqërore të tyre. Bashkia e ka pjesë të detyrimeve të saj ligjore ngritjen dhe funksionimin e këtyre shërbimeve specifike. Plani Social për periudhën 2023-2027 u formulua me qëllim ngritjen dhe funksionimin e një sistemi komunitar shërbimesh të kujdesit shoqëror të aksesueshëm për këdo individ që i ka të nevojshme ato. Hartimit të Planit Social i parapriu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Vorë, i cili identifikon grupet në nevojë për shërbime, madhësinë dhe shtrirjen e tyre në territorin e Bashkisë, shërbimet egzistuese, si dhe nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror. Raporti u hartua mbi bazën e treguesve socialë statistikorë dhe administrativ të mbledhur në periudhën 2021-2023, intervistat gjysëm të strukturuar të zhvilluara me stafin e shërbimeve sociale të Bashkisë, konsultimit me institucione lokale e rajonale që kanë role e përgjegjësi në ofrimin e shërbimeve specifike në territor, si dhe ofruesve të shërbimeve. Prioritetet e formuluar, pjesë e Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, ishin udhërrëfyese në formulimin e këtij Plani.

Aktualisht, bashkia nuk disponon qendra të posaçme ku individët mund të kërkojnë mbështetje dhe asistencë. E vetmja formë e ndihmës që ofrohet nga Bashkia Vorë janë pagesat në CASH, të cilat vijnë nëpërmjet fondeve të qeverisë dhe fondeve të vetë bashkisë. Këto pagesa ofrojnë një ndihmë të vlefshme financiare për individët në nevojë. Analiza e nivelit të shërbimeve sociale në Bashkinë Vorë tregon një potencial të madh për përmirësim dhe zhvillim të infrastrukturës sociale.

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1. Vizioni

1.1 Vizioni

Sistem efektiv komunitar i shërbimeve të kujdesit shoqëror që shmang pabarazinë social ekonomike, parandalon rënien në varfëri dhe përjashtimin social, mbron, fuqizon dhe riintegron çdo pjesëtar të komunitetit.

1.2 Misioni

Bashkia Vorë do të ofrojë për çdo individ që përmbush kushtet ligjore shërbime cilësore të kujdesit shoqëror, që mundësojnë mbrojtjen, fuqizimin dhe ri-integrimin e tij/saj dhe familjes, në respekt të plotë të parimeve dhe standarteve kombëtare në këtë fushë dhe në partneritet me çdo institucion publik e jopublik që ndan role e përgjegjësi të përbashkëta me Bashkinë në këtë fushë.

3. Parimet e Planit Social Vendor

Plani Social Vendor, Bashkia Vorë, synon të sigurojë një përfshirje të gjerë dhe të barabartë të të gjithë grupeve dhe individëve të disavantazhuar, duke respektuar të drejtat e të njeriut dhe duke adresuar sfidat sociale si varfëria, pabarazia, dhe mungesa e aksesit në shërbime të nevojshme. Disa nga parimet dhe hapat që përfshihen në këtë plan janë:

Përfshirja sociale: Sigurimi i aksesit të barabartë për të gjithë në shërbime dhe mundësi, pa dallim dhe përfshirja e të gjithë komuniteteve.

Respektimi i të drejtave të njeriut: Bazuar në dinjitetin e individëve dhe sigurimin e jetesës së tyre dhe përfshirje në shoqëri..

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Ndërtimi i partneriteteve për të arritur qëllimet sociale me organizata jo-qeveritare, sektorin privat dhe aktorët shoqërorë

Trajtimi i varfërisë dhe pabarazisë: Adresimi i sfidave të varfërisë dhe pabarazisë duke ofruar mbështetje për grupet më të prekura.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Përparimi drejt një qëllimi të zhvillimit social vendor të qëndrueshëm duke pasur parasysh mirëqenien afatgjatë të familjeve dhe individëve.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Ruajtja e të dhënave personale të individëve në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Qeverisja e mirë: Sigurimi i transparencës, pjesëmarrjes së qytetarëve, dhe llogaridhënie të plotë në proceset vendimmarrëse.

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Garancia e aksesit të barabartë dhe luftimi i çdo forme të diskriminimit, duke siguruar një mjedis të barabartë për të gjithë.

Këto parime janë thelbësore për të ndërtuar një plan social që adreson nevojat dhe sfidat sociale të banorëve të Bashkisë Vorë, duke siguruar përfshirjen, drejtësinë, dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Hapat specifike të veçantë për të realizuar këto parime përfshijnë:

- Financimi i Fondit Social për shërbime sociale.
- Hartimi dhe zbatimi i politikave lokale të mbështetura në respektimin e të drejtave të njeriut, të fëmijëve dhe barazisë gjinore.
- Sigurimi i aksesit të barabartë tek shërbimet e decentralizuara.
- Ndërtimi i shërbimeve sociale të përshtatura në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive financiare.
- Implementimi i politikave që inkurajojnë pjesëmarrjen e grupeve të interesit dhe monitorimin e zbatimit të planit.

II. ANALIZA E SITUATËS

1. Kuadri strategjik

Plani social vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAE

Dokumentet strategjike

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar;
- ✓ Dokumenti Politik – Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale;
- ✓ Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore;
- ✓ Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale.

Korniza e përgjithshme ligjore, mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).

Dokumente vendore:


- Strategjia Territoriale Bashkia Vorë;
- Plan i Përgjithshëm Vendor Bashkia Vorë.
- Rregullore Bashkia Vorë
- Urdhër për Miratimin e Strukturës së Bashkisë Vorë dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxullë për vitin 2024

2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

Vlerësimi i nevojave

Të dhënat demografike

Analiza e dinamikës së popullsisë në Bashkinë Vorë për periudhën 2021-2023 prezanton një dinamikë të pasur të ndryshimeve demografike në këtë zonë. Me një rritje të përgjithshme prej 1188 banorësh, në vitin 2023 popullsia e Bashkisë ka arritur në 40,787 banorë në krahasim me 39,599 banorë në vitin 2021.



Një pjesë e madhe e popullsisë është përqendruar në qytetin e Vorës, që është kryeqendra e bashkisë, me 53% të banorëve. Njësia Administrative Bërxull strehon 29% të popullsisë, ndërsa Njësia Administrative Prezë ka vetëm 18% të popullsisë. Këto të dhëna tregojnë se qyteti i Vorës dhe Bërxull janë qendrat kryesore të zhvillimit dhe tërheqjes së popullsisë në

Bashkinë Vorë.

Në krahasim me vitin 2021, popullsia e Bashkisë ka shënuar një rritje prej 3% në vitin 2023. Rritja më e madhe është regjistruar në Njësinë Administrative Bërxull me një rritje prej 6%, ndërsa qyteti i Vorës ka shënuar një rritje prej 2%. Kjo sugjeron se Bërxull po zhvillohet me ritme të shpejta dhe po bëhet një zonë atraktive për banorët e rinj.

Duke analizuar grupmoshat, në vitin 2023 shihet një tendencë në ulje të grupmoshës 0-19 vjeç me 96 fëmijë. Vetëm grupmosha 0-4 vjeç ka shënuar një ulje prej 58 fëmijësh, duke treguar uljen e numrit të lindjeve në këtë njësi. Rritja e grupmoshës aktive për punë (19-59 vjeç) me 367 banorë në Bashkinë Vorë për periudhën 2021-2023 tregon një përmirësim të kushteve të jetesës dhe një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në zonë. Ky fenomen mund të lidhet me investimet në infrastrukturë, hapjen e bizneseve të reja



dhe përmirësimin e tregut të punës, të cilat kanë krijuar një mjedis më të favorshëm për jetesë dhe punësim. Përveç kësaj, migrimi i brendshëm nga zonat më pak të zhvilluara dhe mundësitë e përmirësuar për arsim dhe trajnim profesional kanë luajtur një rol të rëndësishëm në tërheqjen dhe mbajtjen e popullsisë aktive për punë në Bashkinë Vorë.

Numri i popullsisë mbi 60 vjeç është rritur me 917 banorë, duke reflektuar një tendencë të rritjes së jetëgjatësisë në Bashkinë Vorë.

Kjo dinamikë demografike është e ndikuar nga disa faktorë kryesorë. Një nga faktorët kryesorë është largimi i popullsisë së re nga bashkia, që lidhet me kërkimin për mundësi më të mira arsimore dhe punësimi në Tiranë ose jashtë vendit. Ulja e numrit të lindjeve është një tjetër faktor i rëndësishëm që reflektohet në grupmoshën 0-4 vjeç. Migrimi nga zona të tjera të Shqipërisë në Vorë ka ndikuar gjithashtu në rritjen e popullsisë, veçanërisht në zonat si Bërshull. Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore dhe kushteve të jetesës ka ndikuar në rritjen e jetëgjatësisë, duke shtuar numrin e popullsisë së moshuar.


Në përfundim, zhvendosja gjeografike e popullsisë tregon një përqendrim të madh në qytetin e Vorës dhe një rritje të qëndrueshme në Bërshull, duke sugjeruar zhvillimin ekonomik dhe urbanizimin e këtyre zonave. Politikat lokale duhet të adresojnë sfidat e migrimit të rinjve dhe të mbështesin krijimin e mundësive të punësimit dhe arsimimit në vend. Rritja e popullsisë së moshuar kërkon përmirësim të shërbimeve shëndetësore dhe sociale, si dhe zhvillimin e infrastrukturës për të përmbushur nevojat e tyre.

Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale

Individë në familje pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme


Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë

Në bazë të ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Vorë mbështet 65 familje me ndihmë ekonomike (NE) në vitin 2023. Këto familje përbëjnë rreth 0.52% të totalit të familjeve në bashki dhe 0.64% të popullsisë. Ndërsa numri i familjeve përfituese ka mbetur pothuajse i pandryshuar nga viti 2021 në 2023 (66 në 2021 dhe 65 në 2023), masa mesatare mujore e ndihmës ekonomike për familje është rritur me 18.45%, duke kaluar nga 6354 lekë në 2021 në 7526 lekë në 2023.




Krahasuar familjet përfituese sipas njësive administrative, qyteti i Vorës ka numrin më të madh të familjeve përfituese, me 55.38% të totalit. Njësia Administrative Prezë ndjek me 24.62% dhe Njësia Administrative Bërshull me 16.92%.

Nga analiza e bërë duke e krahasuar numrin e familjeve përfituese të NE me numritn total të familjeve në Njësitë Administrative rezulton se: në qytetin e Vorës, 0.55% e familjeve përfitojnë ndihmë ekonomike, në Njësinë Administrative Prezë 0.75%, dhe në Njësinë Administrative Bërxullë 0.32%. Ndërkohë, Njësia Administrative Bërxullë, edhe pse ka shënuar rritjen më të madhe të popullsisë gjatë tre viteve të fundit, ka numrin më të ulët të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.




Në vitin 2023, struktura e familjeve që përfituan ndihmë ekonomike në Bashkinë Vorë tregon



një prirje të qartë të përqendrimit të ndihmës te familjet më të mëdha, ku familjet me pesë anëtarë dominojnë si përfitues kryesorë, pasuar nga familjet me tre dhe katër anëtarë. Familjet me dy anëtarë përbënin një pjesë më të vogël të përfituesve, ndërsa familjet me një anëtar ishin më të rralla. Nuk kishte asnjë familje me më shumë se

gjashtë anëtarë që përfitonte ndihmë ekonomike. Analiza e familjeve përfituese të NE në vitin 2023 tregon se familjet me 5 anëtarë përbëjnë pjesën më të madhe të përfituesve, me 26.15%. Pas tyre vijnë familjet me 3 anëtarë (23.08%), 4 anëtarë (21.54%), 6 anëtarë (15.38%) dhe 2 anëtarë (10.77%). Familjet me 1 anëtar përbëjnë vetëm 3.08% të totalit të familjeve përfituese. Nuk ka familje me më shumë se 6 anëtarë që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Në Bashkinë Vorë, struktura demografike e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike tregon një përqindje të lartë të të miturve.



Në total, nga 262 anëtarë që kanë familjet përfituese të ndihmës ekonomike, 117 prej tyre janë të mitur (0-18 vjeç) dhe 48% e tyre janë vajza. Të miturit përbëjnë 44.6% të anëtarëve të familjeve përfituese, ndërsa të rriturit përbëjnë 55.4%. Përqindja e lartë e të miturve në familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Vorë, me një përbërje gjinore të balancuar thekson

nevojën e ngutshme për mbështetje të shtuar për këtë grupmoshë vulnerabël.

Përveç familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, në nëntor 2023, skema e ndihmës mbështet gjithashtu 2 fëmijë me status jetimi dhe 10 viktime të dhunës (një rritje nga 9 viktime në 2021). Nuk ka fëmijë në shërbim kujdestarie ose fëmijë me aftësi të kufizuar që trajtohen me shërbim kujdestarie.

Raporti midis familjeve përfituese dhe familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike mbetet rreth 80% në tre vitet e fundit, duke treguar një konsistencë në përzgjedhjen dhe mbështetjen e familjeve që kanë nevojë për ndihmë ekonomike.


Në vitin 2023, Bashkia Vorë ka mbështetur 9 familje me **ndihmë ekonomike nga Fondi 6%**, një ulje e lehtë nga 11 familje të trajtuara me këtë skemë në vitin 2021. Masa e ndihmës ekonomike mujore për këto familje ka ardhur në rritje, duke reflektuar përpjekjet e Bashkisë për të përmirësuar kushtet e jetesës për familjet në nevojë. Në vitin 2023, masa mesatare mujore e ndihmës ekonomike për familje ishte rreth 4,030 lekë, një rritje prej 8% nga viti 2021, kur kjo vlerë ishte rreth 3,781 lekë. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vorë ka miratuar kritere specifike për përzgjedhjen e familjeve përfituese nga Fondi 6%. Këto kritere përqendrohen kryesisht te familjet me kryefamiljare gra, të cilat përbëjnë mbi 80% të përfituesve.

Ndërkohë, familjet e tjera në nevojë, të cilat nuk përfitojnë nga dy skemat e përmendura të ndihmës ekonomike, mbështeten nga fondet e vetë bashkisë. Numri i këtyre familjeve është dinamik dhe ndryshon në varësi të nevojave të identifikuar dhe burimeve të disponueshme. Në këtë skemë, prioritet u jepet edhe familjeve dhe personave me probleme shëndetësore, duke ofruar ndihmë për të kompensuar shpenzimet për trajtime mjekësore, si kimioterapia. Numri i familjeve të mbështetura është shumë i ulët, duke treguar një mungesë të theksuar të mbulimit të nevojave për familjet në nevojë nga ana e Bashkisë Vorë. Mungesa e një skeme mbështetëse periodike për familjet që nuk përfitojnë asnjë ndihmë ekonomike vjen si pasojë e mungesës së një databaze për familjet dhe individët në vështirësi, duke theksuar nevojën urgjente për zhvillimin e kritereve të qarta për vlerësimin dhe mbështetjen e këtyre familjeve. Bashkia duhet të krijojë një sistem ndihme periodike mujore duke përdorur fondet e veta për të garantuar që asnjë familje në nevojë të mos mbetet pa mbështetje. Vëmendje e shtuar duhet t'u kushtohet edhe individëve të vetmuar në moshë pensioni që nuk përfitojnë pension pleqërie dhe nuk kanë mbushur moshën 70 vjeç për përfitim të pensionit social.

Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike realizohet nga Sektori i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Vorë, në bashkëpunim me administratorët shoqërorë në çdo njësi administrative. Ky sektor është përgjegjës për përzgjedhjen e përfituesve, mbikëqyrjen e shpërndarjes së fondeve dhe sigurimin e zbatimit të kritereve të miratuara.

Punëkërkuarit e papunë

Në Bashkinë Vorë, situata e papunësisë përbën një sfidë të rëndësishme sociale. Sipas të dhënave nga Zyra Vendore e Punësimit për Vorën, janë regjistruar 206 persona si punëkërkuar të papunë (PUPA), nga të cilët 132 janë gra dhe vajza, përfaqësuese të 1.26% të popullsisë në moshë madhore të aftë për punë.




Analiza tregon se % më e lartë e papunësisë është përqendruar në grupmoshat mbi 40 vjeç, që përbëjnë 75.73% të punëkërkuarve, ndërsa të rinjtë 16-25 vjeç përbëjnë një pjesë të vogël të kësaj grupi, me 2.43% për grupmoshën 15-19 vjeç dhe 6% për grupmoshën 20-24 vjeç.

Rreth 48.65% e punëkërkuarve të papunë janë anëtarë të familjeve përfituese të Ndihmës Ekonomike (NE), të cilët janë të detyruar të paraqesin kërkesë për punësim pranë zyrave të punësimit. Pjesa tjetër, 51.58%, janë persona të interesuar për t'u punësuar nëpërmjet Zyrës së

Punësimit. Në mungesë të një zyre punësimi në Bashkinë Vorë, të gjitha nevojat e punësimit trajtohen nga Zyra e Punësimit në Tiranë, çka përbën një sfidë shtesë për punëkërkuessit.

Në aspektin e arsimit, punëkërkuessit në Bashkinë Vorë variojnë nga ata pa arsim deri tek ata me arsim të lartë ose pasuniversitar, me shumicën që kanë përfunduar arsimin 9-vjeçar dhe një pjesë të konsiderueshme që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm dhe atë profesional. Gratë dhe vajzat përbëjnë një pjesë të madhe të punëkërkuessve në çdo nivel arsimor, duke reflektuar nevojën për politika të fokusuara në rritjen e mundësive të punësimit për këtë grup.



Rezulton se 0.17% e punëkërkuessve janë pa arsim, 5.39% kanë arsim fillor, 61.27% kanë arsim 9-vjeçar, 19.12% kanë arsim të mesëm të përgjithshëm, 4.9% kanë arsim të mesëm profesional dhe 7.84% kanë arsim të lartë ose pasuniversitar. Gratë dhe vajzat përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të punëkërkuessve në çdo nivel arsimor.

Papunësia prek veçanërisht grupet vulnerabël në Bashkinë Vorë, duke përfshirë persona me aftësi të kufizuara, anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, gra kryefamiljare dhe të tjerë që kërkojnë punë. Këto grupe janë më të ekspozuara ndaj sfidave ekonomike dhe sociale, duke kërkuar masa të veçanta për të adresuar nevojat e tyre dhe për të siguruar përfshirje të plotë në tregun e punës.



2.43% e PUPA janë persona me aftësi të kufizuara, 0.97% janë anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian, 62.88% janë gra kryefamiljare dhe 33.72% janë të tjerë.


Shërbimet për punësim dhe aftësim ofrohen nga Zyra e Punësimit dhe Qendrat e Formimit Profesional në Tiranë, por vetëm 4 persona nga Bashkia Vorë ndjekin aktualisht kurse të formimit profesional, prej të cilëve 3 janë gra dhe vajza. Shkalla e ulët e pjesëmarrjes në këto kurse lidhet me nivelin e ulët ekonomik të familjeve dhe pamundësinë e tyre për të mbuluar kostot e transportit.

Për të përmirësuar situatën e papunësisë, rekomandohet krijimi i një zyre lokale të punësimit në Bashkinë Vorë për të lehtësuar aksesin e punëkërkuessve dhe ofrimin e mbështetjes financiare për transportin e tyre drejt kurseve të formimit profesional. Gjithashtu, zgjerimi i programeve të trajnimit dhe kualifikimit, veçanërisht për gratë, vajzat dhe grupet vulnerabël, është thelbësor. Krijimi i partneriteteve me bizneset lokale dhe organizimi i fushatave ndërgjegjësuere për të inkurajuar më shumë persona të regjistrohen si punëkërkuess dhe të ndjekin kurse profesionale do të ndihmonte në reduktimin e papunësisë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët e Bashkisë Vorë.

Individë me aftësi të kufizuar

Në Bashkinë Vorë, sipas statistikave të Nëntorit 2023, janë regjistruar zyrtarisht 975 persona me aftësi të kufizuar (AK), që përbëjnë 2.39% të popullsisë. Nga këta, 41.95% janë gra dhe vajza, dhe 55.92% jetojnë në qytetin e Vorës. Një pjesë e konsiderueshme, 469 persona, janë invalidë pune që përfitojnë si nga pagesat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga skema e mbrojtjes sociale, ndërsa 506 të tjerë marrin pagesa për aftësinë e kufizuar. Ndër këta të fundit, 124 persona marrin pagesë për të mbuluar shërbimin e ndihmës personal. Në vitin 2023, numri i përfituesve të AK u rrit me 4.61%, duke arritur një mesatare prej 975 personash në muaj.

Sipas kategorive, 6.46% janë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, 7.59% janë të verbër, 48.10% janë invalidë pune, dhe 37.85% janë persona me AK sipas vlerësimit bio-psiko-social.



Sikurse shihet edhe nga grafiku numri i personave para dhe tetraplegjikë ka mbetur pothuajse i pandryshueshëm në tre vite. Edhe numri i invalideve të punës në dy vitet e fundit është i pandryshueshëm me një ulje në krahasim me vitin 2021. Numri i personave me aftësi të kufizuar me vlerësimin bio-psiko-social ka ardhur në rritje gjatë tre viteve të fundit.

Numri i personave me aftësi të kufizuar që përfitojnë Ndhmës Personal në vitin 2023 u ul me 16.22% krahasuar me vitin 2021. Në vitin 2023, 124 persona me AK përfituan ndihmës personal, krahasuar me 148 në vitin 2021. Kjo ulje është veçanërisht e ndjeshme për personat me AK sipas vlerësimit bio-psiko-social, ulje me 42% (24 persona më pak). Sipas punonjësve të AK, kjo ulje është rezultat i skemës së re të vlerësimit, e cila ka reduktuar përfitimet e padrejta.

Numri i fëmijëve me AK në nivel Bashkie është 71 fëmijë (29.58% janë vajza), ku numrin më të lartë e ka Qyteti Vorë. Vetëm 44 fëmijë ndjekin arsimin 9-vjeçar, nga të cilët 4 janë në grupmoshën parashkollore, 33 ndjekin ciklin 9-vjeçar, dhe 10 ndjekin arsimin e mesëm. Përsa i përket arsimit të lartë, vetëm 1.54% e personave me AK (15 persona) janë të regjistruar, nga të cilët 10 ndjekin arsimin e mesëm dhe 5 arsimin e lartë. Nuk ka asnjë paraplegjik ose tetraplegjik që ndjek arsimin e mesëm apo të lartë. Profesionistët në Bashkinë Vorë theksojnë se kjo vjen si rezultat i ndërgjegjësimit të ulët të prindërve, nivelit të ulët ekonomik të familjeve, dhe rezultateve të dobëta në arsimin 9-vjeçar.

Në tregun e punës, vetëm 5 persona me AK janë të regjistruar si të papunë dhe kërkues pune pranë zyrave të punësimit. Kjo përqindje e ulët lidhet me mentalitetin e familjarëve, nivelin e ulët të jetesës, frikën e humbjes së pagesës së AK pas punësimit, nivelin e ulët arsimor dhe mungesën e një zyre punësimi në Bashkinë Vorë.

Personat me AK në Bashkinë Vorë janë:

- ✓ Paraplegjikë-tetraplegjikë: 63 persona, 37% prej tyre gra dhe vajza, 62 prej të cilëve kanë ndihmës personal, asnjë nuk ndjek arsimin e mesëm apo të lartë.

- ✓ Të verbër: 74 persona, 55% gra dhe vajza, 29 prej të cilëve kanë ndihmës personal, 1 person ndjek arsimin e lartë.
- ✓ Invalidë pune: 469 persona, 41% gra dhe vajza.
- ✓ Persona me AK sipas vlerësimit bio-psiko-social: 369 persona, 41% gra dhe vajza, 33 prej të cilëve kanë ndihmës personal, 15 ndjekin arsimin e mesëm dhe të lartë.

Menaxhimi i skemës së përfitimit të AK realizohet nga Sektori i Shërbimeve Sociale dhe administratorët shoqërorë në çdo njësi administrative, ndërsa vlerësimi i aftësisë së kufizuar kryhet nga Komisionet Shumëdisiplinore në varësi të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë. Bashkia Vorë ka një rol të rëndësishëm në zbatimin e rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinar, garantimin e shërbimeve shoqërore dhe mbështetjen në tregun e punës dhe formimin profesional për personat me AK.

Sfidat kryesore për përkujdesin ndaj personave përfitues të pagesave për shkak të aftësisë së kufizuar përfshijnë sigurimin e aksesit dhe përshtatshmërisë në arsim, mundësitë e punësimit dhe formimit profesional, ndërtimin e qendrave të specializuara për trajnim, sigurimin e burimeve njerëzore, krijimin e partneriteteve dhe bashkëpunimin me organizata të tjera, dhe sensibilizimin e komunitetit për të drejtat e personave me AK.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje

Analiza e situatës së fëmijëve në nevojë në Bashkinë Vorë, bazuar në të dhënat e disponueshme, tregon disa aspekte kyçe në fushën e arsimit, mirëqenies dhe mbrojtjes sociale të fëmijëve. Bashkia Vorë numëron rreth 9087 fëmijë, të cilët përbëjnë rreth 22.28% të popullsisë së saj. Ky numër ka shënuar një rënie prej 96 fëmijësh nga viti 2021 në vitin 2023, duke përfaqësuar një ulje prej 1.04%.

Në Bashkinë Vorë, nuk ka asnjë çerdhe publike apo private për fëmijët e grupmoshës 0-4 vjeç, dhe si pasojë asnjë fëmijë në këtë grupmoshë nuk frekuenton çerdhen.

Për grupmoshën 4-6 vjeç, shërbimi arsimor ofrohet nga 13 kopshte publike, ku marrin pjesë 609 fëmijë, nga të cilët 373 janë vajza. Mungon shërbimi jo publik, privat, për kopshte në bashki. Megjithatë numri i kopshteve publike ka mbetur i njëjtë, numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtet ka rënë me 5.58% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2021. Ky reduktim mund të reflektojë ndryshime demografike, por gjithashtu tregon sfida në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Vlen të përmendet se vetëm një fëmijë me aftësi të kufizuar dhe pesë fëmijë nga familjet që përfitojnë ndihmë ekonomike frekuentojnë kopshtet, duke përfaqësuar më pak se 1% të totalit të fëmijëve në kopshte. Ky fakt ngre shqetësime për integrimin e fëmijëve nga grupet më vulnerabel.


Për fëmijët e grupmoshës 6-14 vjeç, 2917 prej tyre ndjekin arsimin bazë në 12 shkolla 9-vjeçare, me një përfaqësim të barabartë urban dhe rural. Asnjë fëmijë nuk është në kushte të frekuentimit të pjesshëm të shkollës dhe nuk ka raste të braktisjes shkollërore, sipas të dhënave të Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) të Vorës¹.

¹ NJMF nuk raporton të dhëna për fëmijët që kanë braktisur shkollën apo e ndjekin atë pjesërisht

Në nivelin e arsimit të mesëm, vetëm 27.71% e fëmijëve të grupmoshës 16-19 vjeç ndjekin shkollën e mesme, që përkthehet në 704 fëmijë, prej të cilëve 453 janë vajza. Në Bashkinë Vorë ka 3 shkolla të mesme të përgjithshme publike (një në çdo njësi administrative), ku rreth 59% e fëmijëve ndjekin shkollën në qytetin e Vorës dhe 41% në njësitë administrative Prezë dhe Bërçullë. Megjithatë frekuentimi është i mirë, ZVA Vorë eidenton se vetëm një fëmijë nuk e ndjek rregullisht shkollën, dhe dy të tjerë e kanë braktisur arsimin e mesëm.

Në fushën e mbrojtjes sociale, situata është komplekse. Sektori i Shërbimeve Sociale të Bashkisë Vorë ka identifikuar 207 fëmijë në nevojë, që përbëjnë 2.24% të fëmijëve të grupmoshës 0-18 vjeç në nivel bashkie. 0.98% e fëmijëve janë fëmijë pa kujdes prindëror, 6.37% e përbëjnë fëmijë viktime të dhunës, 0.49% janë fëmijë që gëzojnë statusin e jetimit, 57.35% janë fëmijë që jetojnë në familje që përfitojnë NE, dhe 34.8% janë fëmijë që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar. Kryesisht informacioni i prezantuar është i orientuar rreth skemave mbështetëse të mbrojtjes sociale (Ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar, statusi i jetimit apo viktimat e dhunës). Gjatë vitit 2023 një fëmijë është sistemuar në qendër rezidenciale për fëmijët.

Në Bashkinë Vorë, shumica e fëmijëve në nevojë janë të evidentuar në qytetin e Vorës, me një përqindje të konsiderueshme të tyre që jetojnë aty. Ndërkohë, një pjesë e fëmijëve në nevojë ndodhen në Njësinë Administrative Prezë, dhe një pjesë tjetër në Njësinë Administrative Bërçullë.



Mbi 55% e fëmijëve në nevojë paraqitet në qytetin Vorë, 23.04% e tyre janë në Njësinë Administrative Prezë dhe 21.57% në Njësinë Administrative Bërçullë.

Kjo shpërndarje tregon se nevojat për mbështetje sociale janë të përhapura në të gjitha zonat e bashkisë, por janë më të theksuara në qytetin kryesor.

Bashkia Vorë përballlet me mungesën e shërbimeve të specializuara për fëmijët. Nuk ka një shkollë profesionale në bashki dhe të rinjtë duhet të udhëtojnë në Tiranë për formim profesional. Po ashtu, mungojnë shërbimet sociale të dedikuara për fëmijët në nevojë në të gjithë territorin e bashkisë. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, e ngritur brenda sektorit të shërbimeve sociale, ofron mbështetje, por sfidat mbeten të shumta. Një nga sfidat më të mëdha është mungesa e burimeve financiare për ndjekjen e rasteve si dhe mungesa e koordinimit ndërmjet institucioneve. Për shembull, Komisariati i Policisë nuk ka referuar asnjë informacion për fëmijët, dhe të dhënat nga ZVA nuk përputhen gjithmonë me ato të sektorit të NJMF në bashki. Kjo tregon një nevojë të fortë për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të siguruar një qasje më të koordinuar dhe efektive në mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve.

Bashkia Vorë duhet të përqendrojë përpjekjet e saj në rritjen e qasjes në arsim dhe shërbime sociale për të gjithë fëmijët, veçanërisht për fëmijë nga grupet më të prekura. Gjithashtu, është thelbësore të forcohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve për të garantuar mbrojtjen dhe

mirëqenien e plotë të fëmijëve. Në këtë mënyrë, Vorë do të mund të krijojë një mjedis më të sigurt dhe mbështetës për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve të saj

Viktima të dhunës në familje

Në Bashkinë Vorë është emëruar specialisti për dhunën që ndjek, monitoron dhe menaxhon rastet e dhunës në territorin e Bashkisë Vorë. Mekanizmi i Referimit të rasteve të dhunës në familje vepron në nivel vendor konform Protokollit të Menaxhimit të Rasteve në bazë të Ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar dhe VKM 334/2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij”.

Gjatë viteve, 2021, 2022 dhe 2023 ka trajtuar rreth 86 raste të dhunës në familje, paraqitur në tabelën 20, Aneksi 1. Numri i rasteve të dhunës ka ardhur në ulje nga 11 raste me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) në vitin 2021 në 7 raste të trajtuara në vitin 2023 dhe nga 26 rasteme Urdhër Mbrojtje (UM) në vitin 2021 në 19 raste të trajtuara në vitin 2023.

Analiza e situatës së dhunës në Bashkinë Vorë tregon një dinamikë të veçantë ku rastet më të mëdha të dhunës raportohen në zonën e Vorës, ndjekur nga njësia administrative e Bërxullit dhe në fund nga njësia administrative e Prezës.



Në përgjithësi, rastet e raportuara të dhunës kanë treguar një trend zbritjeje në NJA Vorë dhe NJA Bërxull ndërsa një rritje e papërfillshme në NJA Prezë. Sipas diskutimeve me profesionistë në Bashkinë Vorë në zonat rurale të Bashkisë ka dhunë në familje, por ajo mbetet e paraportuar për shkak të mentalitetit, mungesës së informacionit, ndërgjegjësimit të ulët, nivelit të ulët ekonomik dhe varësisë ekonomike, mungesës së besimit tek institucionet.


Bazuar legjislacionit shqiptar rastet e pajisura me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje (UMM), dhe/ose Urdhër Mbrojtje (UM) përfitojnë NE prej 9900 lekësh. Në tre vitet e fundit numri i rasteve të dhunës që kanë përfituar pagesë në CASH ka qene pothuajse i njëjtë. Vetëm rreth 10 raste në vit përfitojnë pagesë si viktimë e dhunës ndërkohë që numri i UMM/UM ka qenë më i lartë. Specialisti gjinor që mbulon çështjet e dhunës e shpjegon këtë situatë me faktin se viktimat: i) nuk kanë informacion mbi ndihmën; ii) nuk janë të interesuara për pagesën; iii) ose janë larguar në bashki të tjera ose jashtë shtetit.

Situata e dhunës në Bashkinë Vorë gjatë viteve 2021-2023 tregon një përqëndrim të dukshëm tek viktimat femra. Numri i grave viktimat të dhunës ka qëndruar i pandryshuar në tre vitet e fundit. Ndërkohë, numri i fëmijëve viktimat të dhunës ka shënuar një ulje të ndjeshme në vitin 2022 dhe një rritje të lehtë në vitin 2023. Në të njëjtën kohë, ka pasur një rritje shqetësuese të rasteve të dhunës ndaj personave të moshës së tretë, ndërsa numri i rasteve të dhunës ndaj burrave ka regjistruar një ulje. Këto tendenca tregojnë nevojën për masa dhe programe për të mbrojtur dhe mbështetur grupet e ndjeshme të komunitetit.



komunitetit.

Dinamika e viktimave të dhunës mbi 18 vjeç në Bashkinë Vorë tregon një variabilitet të ndjeshëm në tre vitet e fundit.



në vitin 2021, duke u reduktuar në 3 raste në vitin 2022 dhe duke u rritur në 8 raste në vitin 2023. Këto variacione shënojnë nevojën për një përqasje të shqyrtueshme dhe të përshtatshme për të adresuar dhe mbrojtur grupet e prekura në komunitetin lokal.

Në Bashkinë Vorë, është ndërtuar sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.

Në Bashkinë Vorë mungojnë shërbime shoqërore në mbështetje të viktimave të dhunës. Mungesa e shërbimeve shoqërore për viktimat e dhunës dhe mungesa e burimeve financiare të Bashkisë për menaxhimin e rasteve të dhunës, mungesa e organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të specializuara në territor për rasteve të dhunës ka bërë që deri në Nëntor 2023 rastet e dhunës në bashki të menaxhohen nga stafi i Bashkisë të ndihmuar me familjarë të viktimave të dhunës. Në disa raste bashkia është mbështetur nga OJF që operojnë në Tiranë Ajo që vlen të përmendet është fakti se numri i rasteve të dhunës që trajtohen nga organizatat ka qenë relativisht shumë i ulët, kryesisht vetëm për rastet e rënda.

Sfidë kryesore për Bashkinë Vorë është koordinimi dhe efektiviteti në menaxhimin dhe parandalimin e rasteve të dhunës në komunitet.

Individë/familje në nevojë për strehim social


Në Bashkinë Vorë, situata e strehimit është e vështirë për banorët, pasi bashkia nuk ofron asnjë skemë mbështetëse për strehim. Përveç kësaj, Vorë është një nga bashkitë e prekura nga tërmeti i vitit 2019, dhe në këto vite, përqendrimi kryesor i autoriteteve lokale ka qenë në sigurimin e qerave dhe fondeve për rikonstruksionin e shtëpive të individëve të cilëve ju shkatërrua ose ju dëmtua shtëpia nga tërmeti. Kjo ka lënë një vakum në ofrimin e shërbimeve për strehim, duke bërë që banorët të kenë vështirësi në gjetjen e mbështetjes për nevojat e tyre për momentin.

Për të përmirësuar situatën Bashkia Vorë (pas tërmetit të 2019), duhet të përqendrohet në tri pika kryesore:

1. Bashkia duhet të intensifikojë bashkëpunimin me Ministrinë e Financave për të siguruar dhe përfituar fonde të mjaftueshme për ndërtimin e shtëpive për familjet në nevojë.
2. Është e rëndësishme që bashkia të fillojë ofrimin e qerasë dhe kredisë të butë për banorët në nevojë, duke siguruar strehim të përkohshëm dhe mbështetje për ata që nuk kanë asnjë strehë.
3. Bashkia duhet të koordinojë dhe të sigurojë fonde të mjaftueshme për rikonstruksionin e shtëpive të personave në nevojë.

Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

Numri i të moshuarve në Bashkinë Vorë përbën 23.52% të numrit të popullsisë, duke arritur në një total prej 9953 personave. Në studimin e nevojave sociale në Bashkinë Vorë, është evidentuar se një pjesë e rëndësishme e popullsisë së moshuar është në kërkim të shërbimeve shoqërore. Nga një total prej 9953 të moshuarish në nivel bashkie, një numër prej 1004 të moshuar është identifikuar si ata që kanë nevojë të veçantë për mbështetje. Analiza tregon se 10.47% e të moshuarve në nivel bashkie janë në nevojë dhe në kërkim të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore. Analizuar në aspektin gjinor, ka një ndarje gjinore pothuajse të barabartë midis të moshuarve ku 49.99% e kërkesave janë zonja dhe 50.01% e kërkesave janë burra. Në të gjitha kategoritë e analizuar rezulton se mbi 50% e rasteve janë gra të moshuara në nevojë. Përjashtim bën grupi i të moshuarve me AK, ku numri i rasteve është qartësisht më i lartë tek të moshuar burra (me 61%).



Në aspektin e shpërndarjes së të moshuarve në nevojë sipas njësive administrative të Bashkisë Vorë, përqindjet specifike janë si vijon: 41% e të moshuarve në nevojë jetojnë në Njësinë Administrative Vorë, 51.1% në Njësinë Administrative Prezë, dhe 7.7% në Njësinë Administrative Bërshull. Ky informacion vë në dukje peshën dhe nevojën për të përqëndruar përpjekjet dhe burimet në këto zona për të siguruar

që këta qytetarë të kenë qasje të përshtatshme dhe të drejtë në shërbimet komunitare dhe mbështetjen që u nevojitet.

Në analizën e nevojave të të moshuarve në njësitë administrative të Vorës, Prezës dhe Bërshullit, vërehet një tendencë e ngjashme midis Vorës dhe Prezës për çështje të kërkesave për

shërbime në familje dhe qendra komunitare.

Njësia Administrative Bërxull shënon një nivel më të ulët të kërkesave për shërbime shoqërore, duke mos regjistruar asnjë kërkesë për shërbime në qendër ditore. Në kontrast, Njësia Administrative Vorë dhe Prezë prezantojnë një përqindje të lartë, duke përfaqësuar rreth 50% të kërkesave të tilla në nivelin e bashkisë. Në aspektin e të moshuarve në nevojë, Njësia Administrative Prezë prezanton shifra të larta për të moshuarit e vetmuar dhe të varfër, duke mbajtur një peshë të rëndësishme në nivel bashkie. Njësia Administrative Vorë, gjithashtu

paraqet një profil të ngjashëm të nevojave për këtë kategori. Në të kundërt, ndjehet një rezistencë e perceptuar ndaj shërbimeve në familje në nivel bashkie, e cila lidhet me mentalitetin dhe frikën e komunitetit për të pranuar të huajt në shtëpitë e tyre.


Bashkia Vorë aktualisht nuk ofron asnjë shërbim shoqëror për të moshuarit, dhe mungesa e një specialisti të specializuar për çështjet e moshës së tretë bën që trajtimi i nevojave dhe problematikave të këtij grupi të realizohet nga Sektori i Mirëqenies Sociale.

Bashkia Vorë përballlet me sfida të konsiderueshme në mbështetjen e popullsisë së moshuar, e cila përfaqëson një përqindje të lartë të numrit të përgjithshëm të banorëve. Mungesa e shërbimeve sociale të specializuara dhe e një specialisti të moshës së tretë në bashki thekson nevojën urgjente për trajtimin e problematikave të këtij grupi. Ndërkohë, numri i lartë i të moshuarve në nevojë për kujdes dhe përkrahje, veçanërisht në njësia administrative Vorë dhe Prezë, kërkon përqendrimin e përpjekjeve dhe burimeve për të garantuar akses të drejtë dhe të përshtatshëm në shërbimet komunitare. Për më tepër, rezistenca e komunitetit ndaj shërbimeve në shtëpi shton një shtresë tjetër kompleksiteti në sigurimin e mbështetjes së duhur për këta individë vulnerabel.

Individë që kanë varësi nga alkooli

Analiza e situatës në Bashkinë Vorë lidhur me përdoruesit e alkoolit tregon një mungesë të qartë të të dhënave dhe koordinimit mes institucioneve të ndryshme. Sektori i Shërbimeve Sociale nuk ka informacion të dokumentuar për individët me varësi nga alkooli, ndërsa nuk ka raste të raportuara nga njësia administrative për këtë grup. Në mungesë të një protokoll apo mekanizmi për bashkëpunim mes institucioneve si Komisaritet e Policisë, Zyra Arsimore dhe Strukturat e Shëndetësisë, bashkia has në pengesa të mëdha në sigurimin e të dhënave të detajuara për grupmoshat dhe gjininë e përdoruesve të alkoolit.

Në këtë kontekst, Bashkia Vorë përballlet me dy sfida kryesore:



Së pari, nevojën për të grumbulluar dhe evidentuar nevojat e individëve që kanë varësi nga alkooli përmes ngritjes së Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN). Kjo do të mundësonte një përjasje koordinuese dhe të strukturuar për identifikimin dhe mbështetjen e këtij grupi në nevojë. Për të realizuar këtë, është thelbësore emerimi i specialistëve të Njesisë së Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave, të cilët do të jenë përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe koordinimin e veprimeve midis sektorëve të ndryshëm.

Së dyti, është problemi i aksesit të këtij grupi në shërbime të nevojshme. Për të adresuar këtë, duhet të krijohet një bashkëpunim i përshtatshëm mes institucioneve për të siguruar që individët me varësi nga alkooli të kenë qasje të lehtë dhe efektive në shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Për të përmirësuar situatën, është e rëndësishme që Bashkia Vorë të zhvillojë dhe zbatojë një protokoll të qartë dhe mekanizma të përbashkët për bashkëpunim mes sektorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe një rritje të koordinimit dhe përdorimit të të dhënave për të adresuar nevojat e individëve me varësi nga alkooli në mënyrë më efektive.

Individë që kanë varësi nga droga

Analiza e situatës në Bashkinë Vorë lidhur me përdoruesit e drogës tregon një mungesë të qartë të të dhënave dhe koordinimit mes institucioneve të ndryshme. Sektori i Shërbimeve Sociale nuk ka informacion të dokumentuar për individët me varësi nga droga, ndërsa nuk ka raste të raportuara nga njësitë administrative për këtë grup. Në mungesë të një protokoll apo mekanizmi për bashkëpunim mes institucioneve si Komisariatet e Policisë, Zyra Arsimore dhe Strukturat e Shëndetësisë, bashkia has në pengesa të mëdha në sigurimin e të dhënave të detajuara për grupmoshat dhe gjininë e përdoruesve të drogës.

Duke qenë në mes të Tiranës dhe Durrësit, Vora është një vend ku kalon trafiku i drogës, gjë që e bën këtë bashki veçanërisht të ndjeshme ndaj problematikës së varësisë nga droga. Ky faktor kërkon një vëmendje të veçantë, sidomos për të rinjtë, të cilët janë më të prirur të ekspozohen ndaj kësaj dukurie dhe të përfshihen në të.

Bashkia Vorë përballlet me dy sfida kryesore: së pari, nevojën për të grumbulluar dhe evidentuar nevojat e individëve që kanë varësi nga droga përmes ngritjes së Njesisë së Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave (NJVRN), dhe së dyti, problemin e aksesit të këtij grupi në shërbime të nevojshme. Për të adresuar këto sfida, është e rëndësishme që Bashkia të zhvillojë dhe zbatojë një protokoll të qartë dhe mekanizma të përbashkët për bashkëpunim mes sektorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe emerimin e specialistëve të cilët do të mbledhin të dhëna dhe do të koordinojnë veprimet për mbështetjen e individëve me varësi nga droga

Persona LGBTIQ+

Bashkia Vorë nuk ka të dhëna të dokumentuara për personat LGBTIQ dhe mungojnë plotësisht strukturat dhe shërbimet specifike për këtë grup. Nuk ka asnjë vlerësim të nevojave të tyre, duke e lënë këtë komunitet të padukshëm dhe të pambrojtur brenda politikave dhe programeve të bashkisë. Mungesa e një protokoll apo mekanizmi për të adresuar çështjet e tyre e bën të vështirë për individët LGBTIQ të kërkojnë dhe marrin mbështetjen e nevojshme. Për të përmirësuar situatën, është thelbësore që bashkia të zhvillojë strategji dhe struktura të dedikuara për identifikimin dhe mbështetjen e nevojave të këtij grupi, duke përfshirë emergjencën e të dhënave dhe krijimin e shërbimeve specifike.

Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

Analiza e nivelit të shërbimeve sociale në Bashkinë Vorë tregon një potencial të madh për përmirësim dhe zhvillim të infrastrukturës sociale. Aktualisht, bashkia nuk disponon qendra të posaçme ku individët mund të kërkojnë mbështetje dhe asistencë.

E vetmja formë e ndihmës që ofrohet nga Bashkia Vorë janë pagesat në CASH, të cilat vijnë nëpërmjet fondeve të qeverisë dhe fondeve të vetë bashkisë. Këto pagesa ofrojnë një ndihmë të vlefshme financiare për individët në nevojë. Bashkia Vorë ka një Sektor të Shërbimeve Sociale, i cili ka potencialin për të ofruar të dhëna për grupet në vështirësi dhe për të vlerësuar nevojat e tyre për shërbime. Aktualisht, të dhënat e siguruar për hartimin e planit social janë gjeneruar kryesisht nga përfituesit e pagesave në CASH, duke ofruar një bazë të rëndësishme për të ndërtuar më tej.

Për të përmirësuar situatën, është e rëndësishme që Bashkia Vorë të investojë në krijimin e qendrave sociale dhe të zhvillojë programe të dedikuara për mbështetje dhe asistencë. Këto mund të përfshijnë shërbime të specializuara për mbështetje psikologjike, trajtimin e varësive dhe ndihmën për rehabilitim dhe reintegrim. Ngritja e strukturave të tilla do të mundësonte një qasje më të integruar ndaj mirëqenies së komunitetit.

Në këtë kontekst, Bashkia Vorë duhet të fokusohet në ngritjen e qendrave sociale që ofrojnë mbështetje psikologjike, asistencë për varësitë dhe programe për rehabilitim dhe reintegrim. Gjithashtu, duhet të zhvillohen shërbime të specializuara për grupe të ndryshme në nevojë, përfshirë të moshuarit, fëmijët në rrezik dhe personat me aftësi të kufizuara. Programe edukative dhe trajnime do të ndihmojnë individët në nevojë të zhvillojnë aftësi të reja dhe të integrohen më mirë në tregun e punës. Për më tepër, rritja e koordinimit institucional do të sigurojë bashkëpunim efektiv mes sektorëve të ndryshëm, si shëndetësia, arsimi dhe policia, në mënyrë që të identifikohen dhe adresohen më mirë nevojat e komunitetit.

Analiza e mjedisit të jashtëm dhe pikat e forta dhe dobëta brenda organizatës

Analiza e burimeve njerëzore

Bazuar në strukturën e Bashkisë Vorë (30.11.2023) dhe Njësive Administrative Prezë dhe Bërxullë Drejtoria e Politikave Sociale është një pjesë e rëndësishme e departamentit të shërbimeve të Bashkisë, nën përgjegjësinë e një drejtori, një përgjegjësi për sektorin e politikave sociale me dy specialist në varësi (Specialisti i NE dhe specialist PAK). Njësia për mbrojtjen e fëmijëve ka në përbërje dy specialist (Koordinator vendor dhe Nënpunës vendor PMF). Gjithashtu në këtë strukturë është përcaktuar sektor më vete Sektori i programeve të strehimit me një përgjegjës dhe dy specialist në trakturë. Ndërkohë në rregulloren e Brendshme të miratuar për Bashkinë Vorë, Drejtoria e Politikave Sociale dhe Strehimit është përshkruar si një drejtori e përbashkët. Ka mospërputhje mes Rregullores dhe organizimit aktual të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror.

Drejtori Politikave Sociale dhe Strehimit ka një sërë detyrash kyçe që kontribuojnë në funksionimin e qëllimshëm dhe ligjor të sektorit të tij. Në këtë drejtim, detyrat e tij përfshijnë:

1. Drejtimi, organizimi dhe kordinimi i punes për përmbushjen e të gjithë detyrave të drejtorisë.
2. Është përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën e mbrojtjes sociale, barazisë gjinore, mbrojtjes së fëmijës, dhunës në familje.
3. Hartimi i Planit të Veprimit Vjetor, në lidhje me Planifikimin dhe Zhvillimin social.
4. Harton strategji dhe politika të kujdesit social, nxitjes së punësimit në ndihmë të kategorive të ndryshme, vecanërisht për të rinjtë.
5. Përgjegjës për mbarvajtjen e punës dhe projekteve sociale.
6. Identifikon burimet kryesore rajonale, mundësitë për investime duke hartuar politika sociale dhe duke marrë masa konkrete në zbatimin e tyre.
7. Analizon situatën e shërbimeve sociale, evidenton problematikat, përgatit planet e veprimit dhe prioritetet e ndërhyrjes në përputhje me planet buxhetore dhe urbane.
8. Zbaton dhe menaxhon programet sociale në mbështetje të kategorive në nevojë për të lehtësuar dhe përmirësuar situatën social-ekonomike të komunitetit.
9. Vlerëson nevojat për shërbime sociale sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.
10. Identifikon burime materiale dhe njerëzore në komunitet për të gjetur mënyra bashkëpunimi për ti ardhur në ndihmë grupeve në nevojë të qytetit të Vorës.
11. Bashkëpunimi dhe ndsërmarrja e iniciativave të përbashkëta me organizata me bazë komunitare.
12. Siguron mbrojtjen morale të emrit të institucionit që përfaqëson dhe mbron në çdo rrethanë interesat e tij.
13. Zbaton strategjitë sociale kombëtare dhe politikat e institucionit në nivel lokal. Ideon, krijon, propozon dhe koordinon veprimtari dhe projekte në kuadër të këtyre strategjive.
14. Mundëson zbatimin e projekteve me impakt shoqëror pranë Bashkisë Vorë; Vlerëson progresin e aktiviteteve dhe raporton rregullisht tek eprori direkt.
15. Të mundësojë një partner të sigurt dhe serioz (Bashkinë e Vorës) për të gjitha shoqatat dhe Institucionet nëpërmjet bashkëpunimit me projekte të përbashkëta.
16. Është përgjegjës për vlerësimin dhe parashtrimin e propozimeve që vijnë nga sektori i politikave sociale dhe Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, tek Titullari i institucionit, partnerë lokalë dhe kombëtarë si dhe donatorë të ndryshëm.
17. Monitoron dhe vlerëson programet sociale të institucionit.
18. Merr aktivisht pjesë në grupe pune me tematika të ndryshme dhe kontribuon në draftimin, finalizimin dhe monitorimin e mjeteve strategjike të këtyre aktiviteteve.
19. Përfaqëson institucionin në nivel lokal dhe kombëtar lidhur me zhvillimet dhe programet sociale si dhe mban lidhje të ngushta me autoritetet lokale dhe OJQ të tjera lokale dhe kombëtare në rajon.
20. Harton propozime, letra interesi dhe projekte të plota në zbatim të programeve sociale dhe vizionit të institucionit mbi shtresat në nevojë.
21. Kujdeset që të dhënat statistikore të fushave që mbulon të përditësohen në përputhje me kërkesat e titullarit.
22. Kryen detyra të caktuara nga eprori direkt.

Në rregullore gjithashtu janë përshkruar detyrat e përgjegjës të Sektorit të Politikave Sociale si dhe detyrat e specialistit të Ndihmës Ekonomike, specialistit të PAK, Specialistit të strehimit, Kordinatorit vendor si dhe detyrat e Nënpunësit vendor PMF.

Detyrat e cituara në rregullore janë të gjitha në përputhje me kërkesat e legjislacionit për NE, PAK dhe Shërbimet Shoqërore për secilin nga pozicionet e mësipërme². Në Bashkinë Vorë mungon Njësia për Vlerësimin e Nevojave dhe Referimit (NVNR).

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit të Drejtorisë së Politikave Sociale nuk është i plotë dhe i organizuar në funksion të grupeve në nevojë. Sipas rregullores specialisti mbulon pjesërisht vetëm detyrat e ngarkuara nga ligji për NE. Ngritja e njësive të vlerësimit të nevojave (NVNR) është detyrim që rrjedh nga Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj, në nenin 36 (pikat 2, 3 dhe 4) ka specifikuar qartësisht detyrimin e Bashkive për të ngritur struktura që përmbushin role dhe funksione specifike në këndvështrimin e ngritjes dhe funksionimit të sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivelin vendor.

Të gjitha këto kanë bërë që bashkia të mos evidentojë kategoritë në nevojë dhe kërkesat e tyre, të mos ketë sistem aktiv të të dhënave (një data bazë me të dhënat) për individët dhe familjet në vështirësi si dhe nevojat e tyre për mbështetje. E gjitha kjo prezantoi vështirësi në grumbullimin e të dhënave për hartimin e planit social.

Nga intervistat me stafin e strukturës përgjegjëse u identifikuan edhe këto sfida kryesore:

- o Vështirësi në menaxhimin e rasteve sociale për shkak të:
 - (i) riorganizimit të stafit
 - (ii) plotësimi i strukturës
 - (iii) rregullore e re me detyra specifike të mirëpërcaktuara
 - (iv) mungesës së buxhetit specifik sipas nevojave që ka çdo rast që menaxhohet;
 - (v) mungesës së një mjeti transporti. Për rastet jashtë njësisë administrative Vorë stafi mbështetet nga strukturat e policisë me transport kur është rast dhune në familje, por për rastet e tjera është e vështirë.
 - (vi) Mungesa e shërbimeve: edhe kur rastet referohen në menaxhim është e pamundur të arrihet mbështetja kur shërbimet mungojnë.

Analiza PESTLE ³

Analiza PESTLE për planin social të Bashkisë Vorë është një mjet i rëndësishëm për të kuptuar ndikimin e faktorëve të jashtëm politikë, ekonomik, shoqëror, teknologjik, ligjor dhe mjedisor në zbatimin e planit social. Këto faktorë ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të ndërsjellë në qeverisjen dhe politikat vendore.

Faktorë Politikë: Ndryshimet politike në nivel Qëndror dhe Vendor mund të ndikojnë në përjasjen dhe financimin e shërbimeve sociale. Ndërhyrjet politike në nivel qendror mund të

² Aktualisht Bashkia Vorë është në fazën e rishikimit të rregullores së saj.

³ PESTLE është një akronim për faktorët politikë, ekonomike, sociale, teknike, ligjorë dhe mjedisorë që mund të ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të bashkisë.

sjellin ndryshime në politikat sociale kombëtare që ndikojnë në financimin dhe zbatimin e programeve sociale lokale.

Faktorë Ekonomike: Stabiliteti ekonomik dhe rritja ekonomike ndikojnë në burimet financiare të Bashkisë për të zbatuar planin social. Kriza ekonomike, inflacioni dhe varësia nga burimet e jashtme mund të ndikojnë në disponueshmërinë e fondeve për shërbimet sociale.

Faktorë Shoqëror: Ndikimi i shoqërisë dhe kulturës lokale në përgjigjen ndaj nevojave sociale është i rëndësishëm për planifikimin dhe zbatimin e programeve sociale. Ndryshimet demografike, strukturat familjare dhe vlerat shoqërore mund të ndikojnë në prioritetet dhe strategjitë sociale të Bashkisë.

Faktorë Teknologjike: Zhvillimet teknologjike mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimeve sociale. Përdorimi i teknologjisë mund të lehtësojë aksesin dhe ofrimin e shërbimeve sociale në mënyrë më të efektshme.

Faktorë Ligjore: Ndryshimet në legjislacionin vendas mund të kërkojnë përshtatje të politikave dhe programeve sociale. Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe rregulloreve të reja sociale është e rëndësishme për të siguruar mbështetje ligjore për zbatimin e programeve sociale.

Faktorë Mjedisore: Aspektet mjedisore si ndryshimet klimatike, mbrojtja e mjedisit dhe sigurimi i resurseve natyrore mund të ndikojnë në gjendjen sociale të komunitetit. Përmbytja e programeve mjedisore dhe përshtatja ndaj sfidave mjedisore është pjesë e përgjegjësisë sociale të Bashkisë Vorë.

Analiza SËOT

1. Zhvillimi ekonomik vendor

Ka një numër shumë të lartë biznesesh të ngritura në territorin e Bashkisë Vorë. Kjo situatë favorizon si të ardhurat që krijon Bashkia, përmes të cilave ajo ka aftësinë të financojë edhe për të zbatuar komponentë të Planit Social, ashtu edhe nxitjen e punësimit të individëve në moshë pune pjesë e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

2. Pozicioni gjeografik

Bashkia Vorë ndodhet gjeografikisht në kufi me Bashkinë Tiranë, në të cilën janë ngritur dhe funksionojnë një numër shërbimesh të kujdesit shoqëror, si dhe ka një numër të konsiderueshëm organizatash të shoqërisë civile. Së bashku këto rritin mundësitë e Bashkisë Vorë si për të përfituar ekspertizë, ashtu dhe për të ngritur partneritete efektive në funksion të zbatimit të komponentëve të Planit Social.

Pika të dobëta

1. Mungesa aktuale në shërbime të kujdesit shoqëror

Bashkia Vorë aktualisht nuk ka të ngritur asnjë formë shërbimi të kujdesit shoqëror, sikurse nuk ka parashikuar në planin afatmesëm buxhetore fonde për ngritjen e këtyre shërbimeve. Nuk janë parashikuar fonde as për menaxhimin e rasteve sociale, duke vështirësuar punën e ekipeve sociale.

2. Mungesa në infrastrukturë dhe burime njerëzore të pamjaftueshme

Analiza mbi burimet njerëzore tregoi se Bashkia nuk ka mjaftueshëm personel për të përmbushur detyrimet ligjore në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Ambjentet e punës së personelit nuk janë të përshtatura për specifikat e punës me individë në nevojë për shërbime, veçanërisht për nevoja të punës me fëmijët apo viktimat të dhunës në familje. Nuk ka buxhet të

dedikuar për menaxhimin e rasteve, kostot përballohen kryesisht nga bashkëpunimi me organizata partnere (kur ka të tilla).

3. Mungesa e eksperiencës dhe praktikave të punës

Kuadri ligjor dhe praktikat e punës për ngritjen dhe funksionimin e sistemit komunitar të shërbimeve njihen nga një pjesë e kufizuar e stafit të shërbimeve sociale të Bashkisë. Personeli ka nevojë për trainime dhe konsultime me ofrues shërbimesh për ta patur më të lehtë përmbushjen cilësisht të detyrave funksionale.

Mundësitë

1. Kuadri ligjor

Aktet nënligjore të Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” kanë përcaktuar qartësisht sistemin e rregullave për ngritjen e shërbimeve komunitare për grupet në nevojë, për mekanizmin e financimit të shërbimeve, sikurse edhe për burimet njerëzore që duhet të egzistojnë në funksion të këtij sistemi. Për shërbimet e kujdesit shoqëror egzistojnë standarte kombëtare të miratura që janë baza mbi të cilën do të ngrihen tipet e shërbimeve që përmban Planit Social.

2. Eksperiencia dhe praktika të ngjashme

Në Bashkinë Tiranë, që ndodhet shumë pranë Bashkisë Vorë ka të ngritura disa tipe shërbimesh të kujdesit shoqëror, që mund të shërbejnë si model praktik për stafin e shërbimit social të Bashkisë.

3. Partneritet me ofrues shërbimesh

Bashkia ka partneritet të ngritur me disa organizata që kanë shprehur angazhim për tu përfshirë në procesin e zbatimit të Planit Social. Gjithsesi ky partneritet duhet zgjeruar në përputhje me parashikimet e Planit Social.

Rreziqet

1. Vështirësi në ngritjen e Fondit Social

Bashkia nuk ka parashikuar në buxhetin tre vjeçar të saj fonde për ngritjen dhe funksionimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkisë do ti duhet të alokoj fonde nga të ardhurat e saj, të kërkoj mbështetje financiare nga Ministria përgjegjëse për çështjet sociale, sikurse të ndërtojë punën me donatorë të ndryshëm me qëllim financimin e komponentëve të këtij Planit.

2. Kapacitetet e kufizuara

Lëvizjet e shpeshta që kanë ndodhur vitet e fundit të personelit të shërbimeve sociale në të dy nivelet e organizimit të Bashkisë, mund të sjellin si rezultat që të ketë humbje në kapacitetet egzistuese për ta ngritur dhe bërë funksional sistemin komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Bashkisë do ti duhet të plotësojë me personel strukturat sipas parashikimeve të Planit Social, të rrisë kapacitetet e stafit egzistues, si dhe të ndërtojë strategji specifike për menaxhimin e burimeve njerëzore me qëllim angazhimin afatgjatë të tyre në këto pozicione.

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Përgjithshëm i PSV për Bashkinë Vorë

Qëllimi i përgjithshëm i Bashkisë Vorë është të krijojë një sistem efektiv komunitar të shërbimeve të kujdesit shoqëror që mbron, fuqizon dhe riintegron çdo pjesëtar të komunitetit, duke shmangur pabarazinë sociale ekonomike dhe duke përmbushur standartet kombëtare të

cilësisë së shërbimeve dhe respektin për të drejtat dhe nevojat e individëve dhe familjeve në nevojë.

OS 1 Të krijojmë një ambient mbështetës dhe motivues në sektorin e çështjeve sociale përmes rristurimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të stafit, për të përmirësuar koordinimin, rritur efikasitetin dhe ofruar shërbime sociale cilësore në të gjithë territorin e Bashkisë Vorë.

Masa 1.1 Riorganizimi i strukturës dhe rishikimi i detyrave funksionale të burimeve njerëzore të Sektorit të çështjeve sociale

Masa 1.2 Ngritja dhe funksionimi i NJVRN në të gjithë territorin e Bashkisë Vorë brenda vitit 2025

Masa 1.3 Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore nëpërmjet organizimit të trajnimeve për zhvillimi i aftësive për të përgatitur stafin për rolet e tyre të reja dhe për të përmirësuar performancën e punës së tyre.

Masa 1.4 Rritja e bashkëpunimit dhe komunikimit brenda sektorit dhe me departamentet e tjera për të përforcuar koordinimin dhe efikasitetin.

OS 2 Ndërtimi dhe zbatimi i sistemit komunitar të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Vorë për të ofruar shërbime shoqërore dhe adresuar nevojat për fuqizim ekonomik, zhvillim personal dhe riintegrim të grupeve në nevojë.

Masa 2.1 Mbështetje financiare për familjet dhe individët në nevojë të cilat nuk përfitojnë nga skemat e pagesave në Cash (NE dhe PAK).

- ❖ 2.1.1 Mbështetje financiare në CASH për x familje në nevojë (jo përfituese nga skema e NE) në vit nga të ardhurat e bashkise/fondet e veta.
- ❖ 2.1.2 Mbështetje financiare në CASH për x persona me aftësi të kufizuar dhe problem të tjera shëndetësore (jo përfitues të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar) në vit nga të ardhurat e bashkisë/fondet e veta.

Masa 2.2 Krijimi i qendrave sociale komunitare për të ofruar shërbime të specializuara dhe të personalizuar për kategoritë në nevojë.

- ❖ 2.2.1 Ngritja e qendrave komunitare shumëfunksionale për familjen dhe kategoritë në nevojë në çdo njësi administrative të Bashkisë Vorë.
- ❖ 2.2.2 Ngritja e shërbimeve shoqërore komunitare për moshën e tretë (kafe me gjyshin) në çdo njësi administrative të Bashkisë Vore.
- ❖ 2.2.3 Ngritja e qendrës së specializuar për Aftësinë e Kufizuar në Bashkinë Vorë.
- ❖ 2.2.4 Ngritja e shërbimeve lëvizese të specializuara për AK për ofrimin e shërbimeve për personat me AK në njësitë administrative

Masa 2.3 Planifikimi i fondit për menaxhimin e rasteve për fëmijët, rastet e dhunës dhe mbështetje e të rinjve të ndjekjen e kurseve të formimit profesional:

- ❖ 2.3.1 Identifikimi i burimeve financiare për mbështetjen e fondeve për menaxhimin e rasteve për fëmijët , rasteve e dhunës dhe të rinjve që duan të ndjekin kurse të formimit profesional:
 - ✓ 2.3.1.1 Analiza e buxhetit ekzistues të Bashkisë Vorë për të identifikuar burimet financiare të disponueshme për këtë qëllim.
 - ✓ 2.3.1.2 Bashkëpunimi me donatorë, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat për të siguruar burime shtesë financiare për menaxhimin e rasteve për

fëmijët, rastet e dhunës dhe ndjekjen e kurseve të formimit profesional nga të rinjtë.

❖ 2.3.2 Planifikimi i përdorimit të fondit për menaxhimin e rasteve:

- ✓ 2.3.2.1 Përcaktimi i prioriteteve për përdorimin e fondit në bazë të nevojave të identifikuara të fëmijëve
- ✓ 2.3.2.2 Përcaktimi i prioriteteve për përdorimin e fondit bazë të nevojave për trajtimin e rasteve të dhunës në komunitet.
- ✓ 2.3.2.3 Përcaktimi i prioriteteve për përdorimin e fondit bazë të nevojave të të rinjve në nevojë që ndjekin kurse të formimit profesional
- ✓ 2.3.2.4 Zhvillimi i një plani të detajuar për përdorimin e fondeve për mbështetjen e kategorive të sipërpërmendura.

OS 3 Ngritja dhe promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien sociale:

Masa 3.1 Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit:

- ❖ 3.1.1 Planifikimi dhe realizimi i fushatave të informimit dhe edukimit në nivel komunitar për të sensibilizuar për çështjet sociale.
 - ✓ 3.1.1.1 Realizimi i 3 fushatave për informimin e komunitetit mbi skemat e mbrotjes sociale në CASH (kush përfiton, mënyrën e përfitimit dhe masën e përfitimit).
 - ✓ 3.1.1.2 Realizimi i 3 fushatave për informimin e komunitetit rreth rolit dhe përgjegjesive të NJMF/PMF dhe koordinatorin e dhunës , shërbimin e ofruar nga këto struktura.
 - ✓ 3.1.1.3 Realizimi i 15 fushatave informimi në shkollat 9 vjecare dhe te mesme te bashkisë Vorë për të drejtat e fëmijëve dhe denoncimin e rasteve të dhunës dhe bullizmit
 - ✓ 3.1.1.4 Realizimi i 15 fushatave informimi për kuadrin legjislativ në shkollat 9 vjecare dhe te mesme te bashkisë Vorë në mbështetje të viktimave të dhunës dhe trafikimit

Masa 3.2 Krijimi i partneriteteve me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera: Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe institucionet tjera për të arritur një ndikim më të madh dhe për të përcaktuar prioritetet në fushën e shëndetit dhe mirëqenies sociale.

- ❖ 3.2.1 Nënshkrimi i 9 marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të zbatimit të planit social me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera në nivel local.
 - ✓ Pesë marrëveshje të nënshkruara me OJF locale dhe nacionale
 - ✓ Katër marrëveshje të nënshkruara me institucionet locale (ZVA, Policia , AKPA dhe Shëndetësia_
- ❖ 3.2.2 Organizimi çdo vit i 2 tryezave të rrumbullakëta me aktorët e mësipërm për monitorimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara të realizohen ne planin social.

IV. PLANI I VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA HAS

Qëllimi i Planit Social Vendor,

Objektivi Specifik 1 “Të krijohet një ambient mbështetës dhe motivues në sektorin e çështjeve sociale përmes rristurimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të stafit, për të përmirësuar koordinimin, rritur efikasitetin dhe ofruar shërbime sociale cilësore në të gjithë territorin e Bashkisë Vorë.”

Objektivat	Indikator	Afati i zbatimit		Fondi për një vit dhe Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
		Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
1	2	3	4	5	6	7
Objektivi specifik 1 (OS1) Të krijohet një ambient mbështetës dhe motivues në sektorin e çështjeve sociale përmes rristurimit dhe fuqizimit të kapaciteteve të stafit, për të përmirësuar koordinimin, rritur efikasitetin dhe ofruar shërbime sociale cilësore në të gjithë territorin e Bashkisë Vorë.						

Masa 1 Riorganizimi i strukturës dhe rishikimi i detyrave funkionale të burimeve njerëzore të Sektorit të Çështjeve Sociale.	1.1 Riorganizimi I strukture aktuale të Sektorit të Shërbimeve Sociale në Bashki	Ngritja dhe fungsionimi i NJVRN	2024	2025	601,056.00 Lek/ Bashkia	Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Sektori i Burimeve Njerëzore	OJF
	1.2 Përmirësimi i procedurave të brendshme për të rritur efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara.	Rregullorje e re e Sektorit të Shërbimeve Sociale e hartuar dhe miratuar nga Keshilli i Bashkisë	2024	2025	36,645.00 Lek/Bashkia	Sektori i Shërbimeve Sociale dhe Sektori i Burimeve Njerëzore	OJF
	2.1 Hartimi i moduleve të trajnitimit	5 Module të realizuara (një për NE, një për AK, një për fëmijët, një për dhunën dhe një për NJVRN)	2024	2025	225,000.00 Lek/Donator (1 pambuluar)	Drejtoria e Shërbimit Social	

trajtimeve (NE, AK, fëmijët, grupet në nevojë, NJVRN)	2.2 Programi i zhvillimit profesional i hartuar dhe miratuar	Eshtë ndërtuar një program trajnim dhe kalendari i trajtimeve	2025	2025	24,430.00 Lek/Bashkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	
	2.3 Realizimi i trajtimeve për NE, AK, fëmijët, dhuna, NJVRN	5 trajtime të realizuara (NE, AK, fëmijët, dhuna, NJVRN) 6 punonjës të sektorit të shërbimeve sociale + 3 administratorët shoqërorë marrin pjesë në çdo trajnim	2024	2025	75,000.00 Lek/ Donator (1 pa mbuluar)	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	
Masa 3 Rritja e bashkëpunimit dhe komunikimit brenda sektorit dhe me departamentet e tjera për të përforcuar koordinimin dhe efikasitetin.	3.1 Organizimi I takimeve periodike për prezantimin e aktivitetit të sektorit dhe nevojat e dalave gjate aktivitetit të tij me departamente të tjera të bashkise	6 takime në vit të organizuara dhe realizuara të sektorit të shërbimeve sociale me sektoret/departamentet e tjera në bashki	2024	2027	175,896.00 Lek/Bashkia	imeve Njerezore	

Objektivi specifik 2 “

Objektivat		Indikator	Afati i zbatimit		Fondi per një vit dhe Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
1	2		Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucio n kontribues (nese ka)
		3	4	5	6	7	
Objektivi specifik 2 (OS2) Ndërtimi dhe zbatimi i sistemit komunitar të shërbimeve shoqërore në Bashkinë Vorë për të ofruar shërbime shoqërore dhe adresuar nevojat për fuqizim ekonomik, zhvillim personal dhe riintegrim të grupeve në nevojë.							
Masa 1 Ngritja e databazës për grupet në nevojë për çdo njësi administrative dhe në nivel Bashkie	1.1 Krijimi i një databaze të përditësuar dhe të aksesueshme për të gjitha grupet në nevojë	Databaza me të dhënat e individëve në nevojë (për çdo kategori) është ngritur dhe përditësohet periodikisht çdo vit	2024	2027	234,528.00 Lek/Bashkia	Sektori i Sherbimit Social Bashkia Vorë	

	1.2 Realizimi i analizës së detajuar për të identifikuar nevojat dhe sfidat specifike të grupeve në ndihmuar, duke përfshirë fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, dhe familjet me të ardhura të ulëta. (NJVRN)	Raporte vlerësimi periodike vjetore të nevojave të grupeve në nevojë të identifikara në Databazën e ngritur dhe rifreskuar	2024	2027	48,860.00 Lek /Bashkia	Sektori i Sherbimit Social Bashkia Vorë	
Masa 2 Mbështetje financiare për familjet dhe individët në nevojë të cilat nuk përfitojnë nga skemat e pagesave në Cash (NE dhe PAK).	2.1 Evidentimi i familjeve dhe individëve në nevojë që nuk përfitojnë mbështetje nga skemat aktuale të mbrojtjes sociale (NE dhe PAK) që kërkojnë mbështetje financiare nga Bashkia.	Databaza me të dhënat e individëve në nevojë (për çdo kategori) që nuk përfitojnë mbështetje nga skemat aktuale të mbrojtjes sociale është ngritur dhe përditësohet periodikisht çdo vit	2024	2027	146,580.00 Lek/Bashkia	Drejtoria e Sherbimit Social / Drejtoria e Financës	

	2.2 Hartimi dhe miratimi në këshillin bashkiak të kriterëve specifike lokale të përfuturit të ndihmës në CASH të familjeve dhe individëve në nevojë që nuk përfitojnë nga skemat e mbrotjes sociale.	Me Vendim të Këshillit Bashkiak miratohen krieteret e përfuturit nga skema mbështetëse me fondet e bashkise, masa mujore e përfuturit dhe numri I përfutuesve (Familje/individë)	2024	2024	73,290.00 Lek/Bashkia	Sektori i Sherbimit Social, Sektori Finances dhe Sektori Juridik
	2.3 Mbështetje financiare në CASH për familje ne nevojë nga te ardhurat e bashkise/fondet e veta	20 familje në nevojë (jo përfutuese nga skema e NE) mbështeten në vit nga të ardhurat e bashkise/fondet e veta.	2024	2027	1,200,000 Lek/Bashkia	Sektori i Sherbimit Social dhe DrejtoriaSektori i Finances

	2.4 Mbështetje financiare në CASH për persona me aftësi të kufizuar dhe probleme të tjera shëndetësore (jo përfitues të pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar) në vit nga të ardhurat e bashkisë/fondet e veta.	20 persona me aftësi të kufizuar jo përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar mbështeten në vit nga mbashkia me të ardhura e bashkisë/fondet e veta.	2024	2027	1,920,000 Lek/Bashkia	Drejtoria e Sherbimit Social	
Masa 3 Krijimi i qendrave shoqërore komunitare për të ofruar shërbime të specializuara dhe të personalizuara për kategoritë në nevojë.j	3.1 Ngritja e qendrave komunitare shumëfunksionale për familjen dhe kategoritë në nevojë në çdo njësi administrative të Bashkisë Vorë.	3 qendra të ngritura në Bashki (një në çdo njësi administrative), 100 të familje dhe individë përfitues	2024	2027	12,000,000.00 Lek/ Donator (1 pambulluar)	Drejtoria e Sherbimit Social / Drejtoria e Financës	OJF

	3.2 Ngritja e shërbimeve shoqërore komunitare për moshën e tretë (kafe me gjyshin) në çdo njësi administrative të Bashkisë Vore	3 qendra të ngritura në Bashki (një në çdo njësi administrative), 100 të moshuar	2024	2027	540,000.00 Lek/ Bashkia		OJF
	3.3 Ngritja e qendrës së specializuar për Aftësinë e Kufizuar në Bashkinë Vorë.	1 qendra të ngritura në Bashki (një në çdo njësi administrative), 50 fëmijë dhe të rritur me AK Përfitojnë shërbime	2024	2027	4,000,000.00 Lek/Donator (I pambuluar)	Drejtoria e Sherbimit Social	OJF
	3.4 Ngritja e shërbimeve lëvizese të specializuara për AK për ofrimin e shërbimeve për personat me AK në njësitë administrative	1 Sherbim lëvizës I shërbimeve të specializuara I gritur për personat me AK 50 persona në vit përfitojnë shërbime pranë vendit ku jetojnë	2024	2027	6,000,000.00 Lek/Donator (I pa mbuluar)	Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF

Masa 4 Fondit për menaxhimin e rasteve për fëmijët, rastet e dhunës dhe mbështetje e të rinjve të ndjekjen e kurseve të formimit profesional	4.1 Burimeve financiare të miratuara për menaxhimin e rasteve për fëmijët, rasteve e dhunës dhe të rinjve që duan të ndjekin kurse të formimit profesional:	4.1.1 Analiza e nevojave të NJMF dhe koordinatorit gjinor për ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve për një vit.	2024	2027	14,658.00 Lek/Bashkia	Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF
		4.1.2 Planifikimi i buxheteve locale të Bashkisë Vorë për ndjekjen dhe menaxhimin e rasteve për fëmijët dhe viktimat e dhunës/trafikimit dhe miratimi ne Keshillin Bashkiak	2024	2027	100,000 Lek/Bashkia	Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF
		4.1.3 Vlerësimi i të rinjve (kryesisht nga zonat rurale) që kërkojnë mbështetje për ndjekjen e kurseve të	2024	2027	14,658.00 Lek/Bashkia	Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF

	formimit profesional për një vit.	2024	2027					Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF
	4.1.4 Planifikimi i buxheteve locale të Bashkisë Vorë për mbështetjen e x të rinjve në vit për ndjekjen e formimit profesional nëpërmjet disbursimit të shpenzimeve të transportit nga fondet e bashkisë.	2024	2027					Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	OJF
	4.1.5 Bashkëpunimi me donatorë, organizata ndërkombëtare dhe sektorin privat për të siguruar burime shtesë financiare për menaxhimin e rasteve për	2024	2027					Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Finances	Donatore ; OJF; Biznese etj

		fëmijët, rastet e dhunës dhe ndjekjen e kurseve të formimit profesional nga të rinjtë.					
--	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi specifik 3 “Ngritja dhe promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për mirëqenien sociale

Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit për ngritjen e vetëdijes për ekzistencën dhe ofrimin e njohurive të qarta në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet e shërbimeve sociale, duke përmirësuar kështu përdorimin e tyre në mënyrë efektive dhe të informuar.”

Objektivat	Indikatori	Afati i zbatimit		Afati i mbartjes	Fondi për një vit dhe Burimi i financimit	Institucionet përgjegjëse	
		Afati i fillimit	Afati i mbarimit			Drejtoria/Sektori/Departamenti (Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi specifik 3 (OS3) Ngritja dhe promovimi i ndërgjegjësimit të komunitetit për mirëqenien sociale							
Ndërgjegjësimi dhe edukimi i komunitetit për ngritjen e vetëdijes për ekzistencën dhe ofrimin e njohurive të qarta në lidhje me rëndësinë dhe përfitimet e shërbimeve sociale, duke përmirësuar kështu përdorimin e tyre në mënyrë efektive dhe të informuar.							

Masa Organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit dhe edukimit:	1.1 Planifikimi dhe realizimi i fushatave të informimit dhe edukimit në nivel komunitar të për sensibilizuar për çështjet sociale.	i) Realizimi i 3 fushatave në vit (një në çdo njësi administrative) për informimin e komunitetit mbi skemat e mbrojtjes sociale në CASH (kush përfiton, mënyrën e përfitimit dhe masën e përfitimit).	2024	2027	43,974.00 Lek/Bas hkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF
		ii) Realizimi i 3 fushatave në vit (një në çdo njësi administrative) për informimin e komunitetit rreth rolit dhe përgjegjesive të NJMF/PMF dhe koordinatorin e dhunës , shërbimin e ofruar nga këto struktura.	2024	2027	43,974.00 Lek/Bas hkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF
		iii) Realizimi i 15 fushatave në vit (një në çdo shkollë) informimi në shkollat 9 vjecare dhe te mesme te bashkisë Vorë për të drejtat e fëmijëve dhe denoncimin e rasteve të dhunës dhe bullizmit	2024	2027	73,290.00 Lek/Bas hkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF
		iv) Realizimi i 15 fushatave në vit në (një në çdo shkollë) informimi për kuadrin legjislativ në shkollat 9 vjecare dhe te mesme te bashkisë Vorë në mbështetje të viktimave të dhunës dhe trafikimit	2024	2027	73,290.00 Lek/Bas hkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i Burimeve Njerezore	OJF

Masa 2 Krijimi i partneriteteve me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera: Bashkëpunimi me organizatat joqeveritare dhe institucionet tjera për të arritur një ndikim më të madh dhe për të përcaktuar prioritetet në fushën e shëndetit dhe mirëqenies sociale.	2.1 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit në kuadër të zbatimit të planit social me shoqërinë civile dhe institucionet e tjera në nivel lokal.	i) Pesë marrëveshje të nënshkruara me OJF lokale dhe nacionale	2024	2025	36,645.00 Lek/Bashkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social dhe Specialisti I komunikimit / Njësia administrative	OJF
	2.2 Organizimi i tryezave të rrumbullakët a periodike me aktorët e mësipërm për monitorimin e masave dhe aktiviteteve të planifikuara të realizohen	ii) Katër marrëveshje të nënshkruara me institucionet lokale (ZVA, Policia , AKPA dhe Shëndetësia)	2024	2025	29,316.00 Lek/Bashkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social dhe Specialisti I komunikimit / Njësia administrative	Institucione lokale
		2 Tryeza të rrumbullakëta të realizuara në vit	2024	2027	48,348.00 Lek/Bashkia	i) Drejtoria e Sherbimit Social ii) Departamenti i finances	

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Planit Social për periudhën 2024-2027 është strukturuar dhe organizuar me kujdes. Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi se sa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme qëllimet dhe objektivat e planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje. Korniza e këtij procesi vlerësimi përfshin elementet kryesore të mëposhtme:

- 1) Çdo aktivitet i planifikuar ka një njësi të caktuar përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e tij. Për të lehtësuar këtë proces, është krijuar një listë treguesish që ndihmojnë në vlerësimin e efektivitetit dhe zbatueshmërisë për çdo aktivitet. Për çdo aktivitet të parashikuar është përcaktuar koha e zbatimit, e vlerësuar në përputhje me dy faktorë: (i) Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave, si dhe (ii) kapaciteti i Bashkisë në këndvështrimin e burimeve njerëzore dhe financiare.
- 2) Në Matricën e Veprimit të Planit janë identifikuar financuesit kryesorë dhe është qartësuar angazhimi për zgjerimin e partneritetit me organizata të shoqërisë civile, ofrues shërbimesh dhe donatorë të mundshëm.
- 3) Plani do të ketë një rishikim çdo një vit dhe përveç kësaj do të ketë monitorim të aktiviteteve sipas afateve kohore specifike, Rishikimi do të përfshijë analizën e ndryshimeve dhe zhvillimeve afatshkurtra lokale, duke reflektuar nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje si dhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuar në periudhën një vjeçare.
- 4) Për të kryer monitorimin do të mblidhen të dhëna dhe informacion i nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar, do zhvillohen konsultime dhe dëgjime periodike me partnerë të Bashkisë dhe përfaqësues të përfituesve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit të Veprimit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikën që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit.
- 5) Monitorimi dhe vlerësimi i Planit do të realizohet përmes ngritjes së Njesisë për Vlerësim dhe Rishikim të Nevojave (NJVRN) dhe rritjes së kapaciteteve të saj për monitorimin dhe vlerësimin e planit të veprimit. Konkluzionet e këtij procesi do të reflektohen në rishikimin vjetor të Planit Social.
- 6) Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë.

VI. ANEKSI 1 - TABELAT

Tabela 1 Të dhëna demografike

Bashkia Vorë	Popullsia në vite	
	(Regjistri civil) 2022	(Regjistri civil) 2023
i) Bashkia/qytet Vore	21,119	21,553
ii) Njësitë Administrative Preze	7,167	7,257
ii) Njësitë Administrative Berxull	11,313	11,977
Total	39,599	40,787

Tabela 2 Të dhëna demografike sipas grupmoshës

Bashkia Vorë	(Regjistri civil) 2023	Popullsia sipas grupmoshes viti 2023								
		0-4 vjec	5-9 vjec	10-14 vjec	15-19 vjec	20-24 Vjec	25-34 vjec	35-49 vjec	50-59 vjec	60 + vjec
i) Bashkia/qytet Vore	21,553	1,030	1,196	1,233	1,343	1,532	3,351	3,923	2,875	5,069
ii) Njësitë Administrative Preze	7,257	347	403	415	452	515	1,128	1,321	968	1,707
ii) Njësitë Administrative Berxull	11,977	573	665	685	746	851	1,862	2,181	1,598	2,817
TOTAL	40,787	1,950	2,264	2,333	2,541	2,898	6,342	7,426	5,441	9,593

Tabela 3 Krahasimi i popullsisë sipas grupmoshave në vite

Grupmosha	Vitet		
	Viti 2021	Viti 2023	Diferenca ne vite

0-4 vjec	2,008	1,950	58
5-9 vjec	2,261	2,264	(3)
10-14 vjec	2,269	2,333	(64)
15-19 vjec	2,645	2,541	104
20-24 Vjec	3,064	2,898	166
25-34 vjec	6,201	6,342	(141)
35-49 vjec	7,068	7,426	(357)
50-59 vjec	5,406	5,441	(35)
60 + vjec	8,676	9,593	(917)
Total	39,599	40,787	(1,188)

Tabela 4. Të dhëna mbi skemën e NE në vite

Kategoritë përfituese të NE	Tetor 2021		Tetor 2022		Tetor 2023	
	Nr.	Fond	Nr.	Fond	Nr.	Fond
Familje përfituese të NE	66	5,032,408	64	5,889,832	65	5,870,724
Individë me status jetimi	2	227,000	2	221,400	2	237,600
Individë viktime të trafikimit						
Individë viktime të dhunës	9	423,000	12	1,438,200	10	1,188,000
Prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh						
a) trinjakë						
b) Katërnjakë						
c) Pesë e më shumë së fëmijë të lindur njëherësh						
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	1	101,000	0	0	0	0

Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare						
Total		5,783,408		7,549,432		7,296,324

Tabela 5. Të dhëna mbi numrin e familjeve përfituese Nëntor 2023

Njësia Administrative	Numri familjeve përfituese të Një sipas Njësive administrative
Bashkia/qytet Vore	36
Njësia Administrative Prezë	18
Njësia Administrative Bërxull	11
Total	65

Tabela 6 Të dhëna mbi familjet përfituese të NE sipas numrit të anëtarëve, viti 2023

Nr	Përshkrimi	Nr. familje përfitojnë NE	Nr. i anëtarëve të familjeve përfituese të NE
1	Familje me 1 anëtar	2	2
2	Familje me 2 anëtarë	7	14
3	Familje me 3 anëtarë	15	45
4	Familje me 4 anëtarë	14	56
5	Familje me 5 anëtarë	17	85
6	Familje me 6 anëtarë	10	60
7	Familje me mbi 6 anëtarë	0	
	Totali	65	262

Tabela 7 Të dhëna mbi familjet aplikuese për NE dhe familjet përfituese të NE

Viti	Nr. familjesh aplikojnë për NE	Nr. familje përfitojnë NE	Raporti përfitues/aplikues
Viti 2021	80	66	82.25%
Viti 2022	81	64	79.01%
Viti 2023	79	65	82.28%

Tabela 8 Fëmijë të familjeve përfituese të NE Nëntor 2023 të ndarë sipas grupmoshave

Fëmije Mosha	NJA Vorë			NJA Prezë			NJA Bërxullë			Total Bashkia Vorë		
	Total fëmije	F	M	Total fëmije	F	M	Total fëmije	F	M	Total fëmije	F	M
0-14	52	19	33	20	11	9	17	11	6	89	41	48
15-18	17	10	7	5	1	4	6	4	2	28	15	13
Total	69	29	40	25	12	13	23	15	8	117	56	61

Tabela 9 Analiza e numrit mesatar të familjeve përfituese të NE dhe fondeve vjetore të NE në total /Burimi Financimi : 6%

Njësia Administrative	2021		2022		2023	
	Nr	Fond	Nr	Fond	Nr	Fond
Bashkia/qytet Vore	5	153,780.00	4	181,826.00	3	119,622.00
Njësitë Administrative Preze	2	119,960.00	2	92,637.00	4	139,392.00
Njësitë Administrative Bërxull	4	218,860.00	4	202,463.00	2	176,234.00
Total	11	492,600.00	10	476,926.00	9	435,248.00

Tabela 10 Të dhëna Punëkërkues të papunë sipas grupmoshës

Grupmosha	Punë kërkues të papunë		
	Numër	Në % nga totali I PUPA	Në % me totalin e popullsisë së aftë për punë
16-19 vjeç	5	2.43%	0.03%
20-24 vjeç	13	6.31%	0.08%
25-29 vjeç	9	4.37%	0.06%
30-39 vjeç	23	11.17%	0.14%
40+	156	75.73%	0.96%
Total	206		

Tabela 11 Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme në nivel Bashkie

Grup- mosha	Total persona të PapunëPunëkërkues të ndarë sipas							
	Qytet/Fshat		Sipas gjinisë		Sipas statusit			
	Urban	Rural	Femra	Meshkuj	PAK	Romë/ Egjptiane	Emig- rantë të kthyer	Gra krye- familjare
16-19 vjeç	5		3	2	0	0	0	1
20-24 vjeç	13		6	7	2	1	0	8
25-29 vjeç	9		8	1	1	1	0	0
30-39 vjeç	23		14	9	1	0	0	5
40+	156		101	55	1	0	0	69
Total	206		132	74	5	2	0	83

Tabela 12 Papunësia sipas nivelit arsimor

	Femra	Meshkuj	TOTALI
--	-------	---------	--------

Niveli arsimor			
Pa arsim	3	0	3
Fillore	7	4	11
9-vjeçare	83	44	127
E mesme përgjithshme	24	15	39
E mesme profesionale	5	5	10
Arsimi Universitar	10	6	16
Total	132	74	206

Tabela 13 Të dhëna analitike e personave të punëkërkues për çdo njësi administrative

Njësia administrative	Punëkërkuese total	Punëkërkuese gra dhe vajza		Punëkërkuese djem dhe burra	
		Total	Punëkërkuese përfituese të ne	Total	Punëkërkues përfitues të ne
Bashkia/qytet Vore	155	100	48	55	28
Njësiti Administrative Preze	12	8	5	4	1
Njësiti Administrative Berxull	37	24	12	13	5
TOTAL	204	132	65	72	34

Tabela 10 . Të dhëna mbi përfitimin e pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar

Përshkrimi	Viti 2021			Viti 2022			Viti 2023		
	Numër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Nu mër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor	Nu mër mesatar PAK	Sa prej tyre femra në %	Fondi total vjetor
1. Para dhe tetraplegjike									
i) Bashkia/qytet Vore	40	37.50 %	13,480,086.00	42	38%	14,580,598.00	41	39%	14,820,577.00
ii) Njësiti Administrative	23	30.43 %	6,508,022.00	22	27%	5,607,806.00	22	32%	5,661,196.00

Total i)+ ii)	63	34.92 %	19,988,108.00	64	34%	20,188,404.00	63	37%	20,481,773.00
2 Të verbër									
i) Bashkia/q ytet Vore	35	57.14 %	5,477,805.00	38	53%	6,226,141.00	38	53%	6,868,293.00
ii) Njësitë Administr ative	31	51.61 %	4,918,538.00	37	49%	6,298,648.00	36	58%	6,724,259.00
Total i) +ii)	66	54.55 %	10,396,343.00	75	51%	12,524,789.00	74	55%	13,592,552.00
3 Invalidë									
i) Bashkia/q ytet Vore	283	42.05 %	10,840,000.00	288	45%	10,843,900.00	283	45%	10,947,600.00
ii) Njësitë Administr ative Preze	188	33.51 %	7,137,200.00	181	33%	7,038,300.00	186	35%	7,029,400.00
Total i) +ii)	471	38.64 %	17,977,200.00	469	40%	17,882,200.00	469	41%	17,977,000.00
4 PAK të tjerë									
i) Bashkia/q ytet Vore	160	43.13 %	19,613,846.00	178	44%	21,556,634.00	181	44%	23,261,578.00
ii) Njësitë Administr ative Preze	172	44.19 %	21,241,733.00	186	42%	21,961,308.00	188	38%	24,010,577.00
Total i) + ii)	332	43.67 %	40,855,579.00	364	43%	43,517,942.00	369	41%	47,272,155.00
TOTAL	932		89,217,230.00	972		94,113,335.00	975		99,323,480.00

Tabela 11. PAK mendorë dhe fizikë sipas moshës

Njësia administrative	PAK mendorë			PAK fizikë			TOTAL
	Total	Mosha 0-18	Mosha 19+	Total	Mosha 0-18	Mosha 19+	
i) Bashkia/qytet Vore	126	20	106	51	7	44	177
ii) Njësitë Administrative Preze	43	13	30	28	1	27	71

iii) Njësiti Administrative Berxull	78	10	68	43	6	37	121
Total i+ii+iii	247	43	204	122	14	108	369

Tabela 12. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e mesëm

Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Nr. mesatar persona sh	Fondi vjetor ALL	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike						
i) Bashkia/qytet						
ii) Njësiti Administrative						
2 Të verbër						
i) Bashkia/qytet						
ii) Njësiti Administrative	1	147,720.00				
3 Invalidë						
i) Bashkia/qytet						
ii) Njësiti Administrative						
4 PAK të tjerë						
i) Bashkia/qytet	0	-	0		5	417,266.00
ii) Njësiti Administrative	3	548,816.00	4	635,988.00	5	1,360,601.00
Total 1+2+3+4	4	696,536.00	4	635,988.00	10	1,777,867.00

Tabela 13. Analiza e PAK që vazhdojnë arsimin e lartë

Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor	Nr. mesatar personash	Fondi vjetor
1. Para dhe tetraplegjike						
i) Bashkia/qytet						
ii) Njësiti Administrative						
2 Të verbër						
i) Bashkia/qytet						
ii) Njësiti Administrative	1	37,743.00	1	307,608.00	1	284,025.00

3 Invalidë						
<i>i) Bashkia/qytet</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
4 PAK të tjerë						
<i>i) Bashkia/qytet</i>	0	-	1	218,754.00	3	695,628.00
<i>ii) Njësitë Administrative</i>					1	90,174.00
Total 1+2+3+4	1	37,743.00	2	526,362.00	5	1,069,827.00

Tabela 14. Përfitimi i ndihmës personal

Kategoritë e PAK sipas Njësie Administrative	Viti 2021		Viti 2022		Viti 2023	
	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor/ ALL	Numër mesatar PAK përfitues të Ndihmës Personal	Fondi total vjetor/ALL
1. Para dhe tetraplegjike						
<i>i) Bashkia/qytet Vore</i>	39	5,473,412.00	41	6,022,380.00	41	6,204,519.00
<i>ii) Njësitë Administrative</i>	22	3,554,298.00	21	3,196,878.00	21	3,197,962.00
Total i) +ii)	61	9,027,710.00	62	9,219,258.00	62	9,402,481.00
2 Të verbër						
<i>i) Bashkia/qytet Vore</i>	15	2,367,470.00	15	2,321,220.00	15	2,468,520.00
<i>ii) Njësitë Administrative</i>	15	2,393,090.00	19	3,063,452.00	14	2,642,077.00
Total i) + ii)	30	4,760,560.00	34	5,384,672.00	29	5,110,597.00
3 Invalidë						
<i>i) Bashkia/qytet Vore</i>						
<i>ii) Njësitë Administrative</i>						
4 PAK të tjerë						
<i>i) Bashkia/qytet Vore</i>	31	4,311,330.00	28	3,726,002.00	9	3,813,282.00
<i>ii) Njësitë Administrative</i>	26	3,552,440.00	26	3,290,334.00	24	3,221,002.00
Total i) + ii)	57	7,863,770.00	54	7,016,336.00	33	7,034,284.00
TOTAL	148	21,652,040.00	150	21,620,266.00	124	21,547,362.00

Tabela 15. Të dhëna për situatën aktuale të fëmijëve në nevojë

Përshkrimi	Total	M	F
Fëmijë në konflikt me ligjin			
Të shfrytëzuar për punë			
Viktima të trafikimit/të mundshme trafikimi			
Jetim	2		2
Fëmijë 0-18 vjeç e lart në familje me NE	117	56	61
Fëmijë me AK	71	50	21
Fëmijë pa kujdes prindëror	2	2	
Fëmijë viktima të dhunës	13	8	5
Fëmijë në shërbim kujdesi alternative			
Nr. total i fëmijëve në kujdes rezidencial në fund të vitit	1	1	0
Nr. fëmijëve në shtëpinë e foshnjës në fund të vitit	0	0	0
Nr. i fëmijëve me AK në kujdes rezidencial publik (në të gjitha institucionet) në fund të vitit	0	0	0
Fëmijë në situatë rruge	0	0	0
Fëmijë që nuk shkojnë në shkollë rregullisht (15-18 vjeç)	1		1
Total	207	117	90

Tabela 16 Të dhëna analitike për fëmijët në nevojë sipas njësive administrative

Njësia Administrative	Pa kujdes prindëror			Viktima të dhunës			Jetimë			Fëmijë në familje me NE			Fëmijë me AK		
	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M	Total	F	M
Bashkia/qytet Vore	0	0	0	5	3	2	0	0	0	69	29	40	39	8	31
Njësitë Administrative Preze	2	2	0	5	3	2	1	1	0	25	12	13	14	7	7
Njësitë Administrative Berxull	0	0	0	3	2	1	0	0	0	23	15	8	18	6	12
Totali	2	2	0	13	8	5	1	1	0	117	56	61	71	21	50

Tabela 17 Për numrin e kopshteve publike dhe frekuentimin e tyre për çdo Njësi Administrative

Njesitë Administrative	Numri i Kopshteve	Nr femijeve total			Fëmijë total te ndare sipas kategorive						
		Total	F	M	Fëmijë nga familje me NE	Fëmijë me status jetimi	Në Kujdestati	Fëmijë me AK	Etni rom/Egjptian	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Të tjere
Bashkia/qytet Vore	7	307	142	165	5	0	0	1	0	0	0
Njësitë Administrative Preze	3	109	55	54	1	0	0	0	0	0	0
Njësitë Administrative Berxull	3	193	76	117	0	0	0	0	0	0	0
Bashkia total	13	609	273	336	6	0	0	1	0	0	0

Tabela 18 Tabela për numrin e shkollave 9 vjeçare dhe frekuentimin e tyre për çdo Njësi Administrative (Arsimi publik)

Njesitë Administrative	Numri i Shkollave	Nr femijeve total			Fëmijë total te ndare sipas kategorive						
		Total	F	M	Fëmijë nga familje me NE	Fëmijë me status jetimi	Në Kujdestati	Fëmijë me AK	Etni rom/Egjptian	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Të tjere
Bashkia/qytet Vore	7	1421	674	747	53	1	0	24	2	0	0
Njësitë Administrative Preze	3	403	192	211	12	0	0	6	0	0	0
Njësitë Administrative Berxu	2	1093	495	598	12	1	0	13	0	0	0
Bashkia total	12	2917	1361	1556	80	2	0	43	2	0	0

Tabela 19 Tabela për numrin e shkollave të mesme dhe frekuentimin e tyre për çdo Njësi Administrative (arsimi publik)

Njesitë Administrative	Numri i Shkollave	Nr femijeve total			Fëmijë total te ndare sipas kategorive						
		Total	F	M	Fëmijë nga familje me NE	Fëmijë me status jetimi	Në Kujdestati	Fëmijë me AK	Etni rom/Egjptian	Viktima të dhunës dhe trafikimit	Të tjere
Bashkia/qytet Vore	1	415	281	134	17	1	0	2	2	0	0
Njësitë Administrative Preze	1	47	29	18	3	0	0	2	0	0	0
Njësitë Administrative Berxu	1	242	143	99	25	1	0	0	0	0	0
Bashkia total	3	704	453	251	45	2	0	4	0	0	0

Tabela 20. Të dhëna mbi dhunën

Të dhëna	Vitit 2021	Viti 2022	Viti 2023
UMM	11	6	7
UMM	26	17	19
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës	0	0	0
Gra	12	12	12
Fëmijë	9	3	4
Të moshuar	1	1	5
Burra	5	2	3
Karakteristika të viktimave të dhunës mbi 18 vjeç	0	0	0
Të papunë	3	7	5
Përfitues të NE	1	3	3
Të Pastrehë	3	2	8
Total Bashkia	37	23	26

Tabela 21. Strehimi/bonusi i qirasë

	Aplikime		Përfitues të bonusit të qerases gjatë viteve							
	Nr. total gjatë vitit	Femra në %	Përfitues total gjatë vitit	Nga skema e NE	PAK	Jetim	Gra k/familjare	Viktim a të dhunës/urdhër mbrotje	Etni rom/egjiptian	Të tjerë
Viti 2021										
i) Qyteti Vorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
ii) Njësitë Adm.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total i+ ii	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Viti 2022	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
i) Qyteti Vorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
ii) Njësia Adm.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total i+ ii	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Viti 2023	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
i) Qyteti Vorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
ii) Njësia Adm.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Total i+ ii	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
-------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Tabela 22 Të dhëna për moshën e tretë në nevojë viti 2023

Kategoritë e të moshuarve në nevojë	Të moshuar në nevojë			
	Vore	Preze	Bërxull	Total
Të moshuar që kërkojnë shërbim në familje	10	17	2	29
Nr I të moshuarve që kërkojnë shërbim në qendër ditore	112	116	0	228
Nr I të moshuarve që kërkojnë shërbim rezidencial	8	17	0	25
Të moshuar të vetmuar	51	133	1	185
Të moshuar të sëmurë	52	17	12	81
Të moshuar të braktisur	3	4	0	7
Të moshuar të varfër	55	133	5	193
Të moshuar me AK	122	76	58	256
Total të moshuar	413	513	78	1004

Tabela 23 Të moshuar në nevojë për çdo njësi administrative sipas gjinisë

Njësia Administrative	Total	F	M
Vorë	413	200	213
Prezë	513	267	246
Bërxull	78	34	44
Total	1,004	501	503

Tabela 24. Tabela e shërbimeve ekzistuese dhe nevojat për shërbime

Shërbime për çdo grup në nevojë	Shërbime ekzistuese			Shërbime të kërkuara	
	Numër shërbimesh	Numër përfituesish	Numër përfitues/ totalin e popullatës sipas grupmoshës	Shërbimi	Nr. Përfituesish
1-Çerdhe	0	0	0	2 çerdhe, një në qytetin e Vorëit	90 fëmijë 0-4 vjeç

				dhe një në NJA Bërxull	
2-Shërbime për të rinjtë	0	0	0	Qendër rinore	100 fëmijë dhe të rinj
3-Shërbime për fëmijët	0	0	0	Qendër ditore për fëmijën dhe familjen në	60 fëmijë 6-14 vjeç dhe 30 familje
4-Nxitje e formimit profesional për të rinjtë dhe të rejtat në zonat rurale	0	0	0	Financimi i shpenzimeve të transportit për të rinjtë dhe të rejtat, banues në zonat rurale, që ndjekin kurse të formimit profesional	10 të rinj 15-25 vjeç
5- Qendër shërbimi e specializuar	0	0	0	Shërbim të specializuar (logopedi dhe fizioterapi)	i) 14 fëmijë 0-14 vjeç; ii) 3 fëmijë 15-18 vjeç;
6-Qendra shumëfunktionale komunitare për familjen dhe grupet ne nevojë	0	0	0	2 (du) një në qytetin e Vorës dhe një në NJA Preze	120 individe
7-Qender shërbimi lëvizëse për AK	0	0	0	1 (një) qendër lëvizëse: i) PAK	i) 35-40 PAK në javë përfitojnë shërbime

KRYETARI
Blerim SHERA

ME URDHËR DHE DELEGIM
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Taulant FEJZULLA

